



Nga Samiti i Ankarasë 2026, konfirmohet lajmi historik: Tirana do të presë Samitin e ardhshëm të NATO-s

» faqe 2



KRYEMINISTRI RAMA INAUGURON SHKOLLËN KOMBËTARE TË FLUTURIMIT: NJË INVESTIM STRATEGJIK PËR TË ARDHMEN E FORCËS AJRORE DHE FORCAVETË ARMATOSURA

Kryeministri Rama inauguron Shkollën Kombëtare të Fluturimit, një investim strategjik për modernizimin e Forcës Ajrore dhe fuqizimin e kapaciteteve mbrojtëse të vendit. Me pjesëmarrjen e kryeministrit Edi Rama, ministrit të Mbrojtjes Ermal Nufi, shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, gjeneralletjënant Arben Kingji, drejtuesve të lartë të Forcave të Armatosura, partnerëve...

faqe 5



REGJIMENTI I KËMBËSORISË SË VERIUT NIS KONTINGJENTIN E RADHËS NË MISIONIN E NATO-S

Forca Tokësore përcolli kontingjentin e radhës të Regjimentit të Këmbësisë së Veriut (RKV), i cili do të marrë pjesë në misionin e NATO-s Forward Land Forces (FLF), të dislokuar në Novo Selo, Bullgari. Ushtarakët shqiptarë nisen drejt misionit me një nivel të lartë përgatitjeje profesionale, gatishmërie dhe përkushtimi, për të kontribuar në forcimin e mbrojtjes kolektive të Aleancës...

faqe 5



KUSH PO UA VRET FËMIJËRINË FËMIJËVE TANË?

Çfarë po ndodh me të rinjtë shqiptarë? Ka ngjarje që nuk zgjasin më shumë se disa minuta, por tronditin një shoqëri për vite me radhë. Ka pamje që nuk duhen transmetuar në televizion, jo sepse janë të papërshtatshme, por sepse janë një akuzë e rëndë ndaj të gjithëve ne. Dhe ka britma që nuk dëgjohen vetëm nga një vajzë e dhunuar, por nga vetë ndërgjegjja e një kombi. Ngjarja e Fierit nuk është thjesht një kronikë policore. Nuk është një konflikt mes adoleshentësh. Nuk është një zënkë që doli...

faqe 8



Nga Samiti i Ankarasë 2026, konfirmohet lajmi historik: Tirana do të presë Samitin e ardhshëm të NATO-s

Në një mjedis ndërkombëtar të karakterizuar nga sfida të shumta të sigurisë, tensione gjeopolitike dhe nevoja për një arkitekturë mbrojtëse gjithnjë e më të konsoliduar, Samiti dyditor i NATO-s në Ankara shënoi një moment të rëndësishëm për Aleancën Atlantike dhe për të gjitha vendet anëtare të saj. Liderët e 32 vendeve aleate, së bashku me drejtuesit e institucioneve kryesore euroatlantike dhe partnerë ndërkombëtarë, diskutuan mbi drejtimin strategjik të NATO-s në dekadat e ardhshme, duke marrë vendime që do të ndikojnë drejtpërdrejt në sigurinë kolektive të hapësirës euroatlantike.

Në përfundim të punimeve, Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Mark Rutte, dha një lajm me rëndësi të veçantë për Shqipërinë: **Samiti i ardhshëm i NATO-s do të zhvillohet në Tiranë gjatë vitit 2027.**

Ky vendim nuk përfaqëson vetëm zgjedhjen e një qyteti pritës, por është një vlerësim politik, diplomatik dhe strategjik për vendin tonë, që prej më shumë se pesëmbëdhjetë vitesh është pjesë aktive e Aleancës.

Ky është një moment historik për Republikën e Shqipërisë. Për herë të parë që nga anëtarësimi në NATO në vitin 2009, vendi ynë do të presë samitin më të rëndësishëm politik dhe ushtarak të Aleancës, duke u shndërruar për disa ditë në qendrën e vendimmarrjes strategjike të sigurisë euroatlantike.

NJË SAMIT NË KOHË SFIDASH GLOBALE

Punimet e Samitit u zhvilluan në një kohë kur mjedisi ndërkombëtar i sigurisë vazhdon të mbetet kompleks.

Lufta në Ukrainë, zhvillimet në Lindjen e Mesme, kërcënimet hibride, sulmet kibernetike, siguria energjetike dhe konkurrenca strategjike ndërmjet fuqive globale ishin në fokus të diskutimeve të liderëve.

Në këtë kontekst, Aleanca riafirmoi se mbrojtja kolektive mbetet shtylla themelore e NATO-s dhe se investimet në kapacitetet ushtarake nuk janë më një zgjedhje politike, por një domosdoshmëri strategjike.

Deklarata përfundimtare e Samitit përcolli një mesazh të qartë: NATO mbetet e bashkuar, e vendosur dhe e gatshme të përballlet me çdo sfidë ndaj sigurisë së vendeve anëtare.

SHQIPËRIA FITON BESIMIN E ALEANCËS

Konfirmimi i Tiranës si mikpritëse e Samitit 2027 ishte padyshim momenti më i rëndësishëm për delegacionin shqiptar. Në Ankara, Shqipëria u përfaqësua nga Kryeministri Edi Rama, Ministri i Mbrojtjes Ermal Nufi dhe delegacioni



shtetëror që po punon për përgatitjen e organizimit të samitit.

Vendimi i Aleancës konsiderohet rezultat i rolit gjithnjë në rritje të Shqipërisë në strukturat euroatlantike, pjesëmarrjes aktive në misionet ndërkombëtare, kontributit në operacionet e NATO-s dhe investimeve të vazhdueshme në modernizimin e Forcave të Armatosura.

Në harkun e më shumë se një dekade e gjysmë, Shqipëria ka kaluar nga statusi i një vendi përfitues të sigurisë në një kontribuues aktiv të saj.

Ushtarakët shqiptarë kanë shërbyer krah për krah me aleatët në Afganistan, Kosovë, Irak, Letoni, Bullgari dhe në misione të tjera të NATO-s dhe Bashkimit Evropian, duke dëshmuar profesionalizëm dhe përkushtim.

Organizimi i Samitit në Tiranë është, në këtë kuptim, një njohje e këtij kontributi.

MESAZHI I MARK RUTTE

Në konferencën përmbyllëse të Samitit, Sekretari i Përgjithshëm Mark Rutte theksoi se Aleanca po hyn në një etapë të re të forcimit të mbrojtjes kolektive.

Ai nënvizoi se vendimi për organizimin e samitit të ardhshëm në Shqipëri është pjesë e vizionit të NATO-s për një Aleancë të bashkuar, ku çdo vend anëtar ka peshën dhe përgjegjësinë e vet.

Rutte pranoi se ekzistojnë diferenca në ritmin e investimeve të vendeve anëtare, por theksoi se të gjitha shtetet tashmë kanë marrë një angazhim të përbashkët për të rritur kapacitetet ushtarake.

Sipas tij, debati brenda Aleancës është një element force dhe jo dobësie, ndërsa uniteti politik mbetet më i fortë se kurrë.



Në këtë frymë, Samiti i Ankarasë konfirmoi se NATO vazhdon të mbetet organizata më e fuqishme ushtarake në botë dhe garancia kryesore për sigurinë e më shumë se një miliard qytetarëve të vendeve anëtare.

RRITJA E INVESTIMEVE NË MBROJTJE, PRIORITET I RI I ALEANCËS

Një nga vendimet më domethënëse të Samitit të Ankarasë ishte miratimi i angazhimit politik për rritjen progresive të shpenzimeve të mbrojtjes deri në nivelin 5 për qind të Prodhimit të Brendshëm Bruto. Ky objektiv shënon ndryshimin më të madh në politikën e investimeve të NATO-s, që nga përfundimi i Luftës së Ftohtë dhe pasqyron realitetin e ri të sigurisë ndërkombëtare.

Aleanca vlerëson se mjedisi strategjik ka ndryshuar rrënjësisht. Lufta në Ukrainë, tensionet në Lindjen e Mesme, kërcënimet hibride, sulmet kibernetike, sabotimi i infrastrukturës kritike dhe zhvillimi i teknologjive ushtarake kërkojnë një ritëm të ri investimesh dhe modernizimi.

Për vendet anëtare kjo nënkupton jo vetëm rritje të buxheteve ushtarake, por edhe investime në sisteme të avancuara të mbrojtjes ajrore, inteligjencë artificiale, mbrojtje kibernetike, logjistikë, infrastrukturë strategjike dhe rritje të gatishmërisë operationale të forcave.

Në këtë kuadër, vendimi i Ankarasë konsiderohet si një plan afatgjatë për ndërtimin e NATO-s së dekadës së ardhshme.

SHQIPËRIA NË RRUGËN E PËRMBUSHJES SË ANGAZHIMEVE

Ministri i Mbrojtjes, Ermal Nuçi, theksoi se Shqipëria ka bërë përparim të ndjeshëm në përmbushjen e objektivave të Aleancës. Sipas tij, buxheti i mbrojtjes ka ardhur në rritje nga viti në vit, ndërsa investimet janë orientuar drejt modernizimit të Forcave të Armatosura dhe rritjes së kapaciteteve operationale. Ai bëri të ditur se shpenzimet që lidhen drejtpërdrejt me mbrojtjen përbëjnë tashmë rreth 2.2 për qind të Prodhimit të Brendshëm Bruto, ndërsa një pjesë tjetër e konsiderueshme investohet në fusha të lidhura me sigurinë, si mbrojtja kibernetike, infrastruktura kritike dhe sistemet mbështetëse. Sipas ministrit, Shqipëria ndodhet në atë që NATO e konsideron një “rrugë të besueshme” drejt realizimit të objektivave të reja.

Ky proces nuk lidhet vetëm me rritjen e shpenzimeve financiare, por me krijimin e kapaciteteve reale ushtarake që i shërbejnë mbrojtjes kolektive të Aleancës.

MODERNIZIMI I FORCAVE TË ARMATOSURA

Vitet e fundit Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë kanë hyrë në një fazë të re transformimi. Investimet janë përqendruar në modernizimin e pajisjeve, rritjen e mobilitetit operacional, zhvillimin e kapaciteteve

të mbrojtjes ajrore, forcimin e mbrojtjes kibernetike dhe përmirësimin e infrastrukturës ushtarake.

Njëkohësisht ka vijuar procesi i rritjes së ndërveprueshmërisë me forcat aleate, përmes pjesëmarrjes në stërvitje shumëkombëshe, misione ndërkombëtare dhe programe të avancuara të edukimit ushtarak.

Këto investime nuk synojnë vetëm plotësimin e standardeve të NATO-s, por krijimin e një force moderne, fleksibël dhe të aftë për t’u përballur me sfidat e reja të sigurisë.

NJË SAMIT QË RRIË PESHËN GJEOSTRATEGJIKE TË SHQIPËRISË

Vendimi për zhvillimin e Samitit të NATO-s në Tiranë nuk është vetëm një ngjarje protokollare.

Ai rrit ndjeshëm profilin ndërkombëtar të Shqipërisë dhe e pozicionon vendin si një aktor me rëndësi në arkitekturën e sigurisë së Evropës Juglindore.

Për disa ditë, Tirana do të jetë qendra ku do të mblidhen krerët e shteteve dhe qeverive të Aleancës, drejtuesit më të lartë ushtarakë, ministrat e mbrojtjes, ekspertët e sigurisë dhe përfaqësues të organizatave partnere.

Përgatitja e këtij organizimi kërkon koordinim të gjerë institucional, standarde të larta sigurie dhe bashkëpunim të ngushtë ndërmjet Ministrisë së Mbrojtjes, Forcave të Armatosura, Policisë së Shtetit dhe institucioneve të tjera përgjegjëse.

Nga ana tjetër, samiti do të shërbejë edhe si një mundësi për të prezantuar kapacitetet organizative të Shqipërisë, zhvillimet infrastrukturale dhe potencialin e saj si faktor stabiliteti në rajon.

UNITETI, FJALA KYÇE E SAMITIT

Në përmbyllje të punimeve, mesazhi më i fortë që doli nga Ankaraja ishte ai i unitetit.

Pavarësisht debateve mbi ritmin e investimeve, prioritetet kombëtare apo sfidave ekonomike, të gjitha vendet aleate riafirmuan se siguria kolektive mbetet përgjegjësi e përbashkët.

Sekretari i Përgjithshëm Mark Rutte nënvizoi se NATO mbetet aleanca ushtarake më e fuqishme në botë pikërisht sepse mbështetet mbi solidaritetin, konsultimin politik dhe vendimmarrjen kolektive.

Në një kohë kur kërcënimet janë bërë më të ndërlikuara dhe më të paparashikueshme, Aleanca synon të ruajë epërsinë teknologjike, gatishmërinë operationale dhe aftësinë për t’u përgjigjur me shpejtësi ndaj çdo krize.

TIRANA 2027, NJË PËRGJEGJËSI QË KALON PËRTEJ ORGANIZIMIT

Për Shqipërinë, mikpritja e Samitit të NATO-s në vitin 2027 është shumë më tepër sesa organizimi i një aktiviteti të nivelit të lartë ndërkombëtar. Ajo përfaqëson kulmin e një rrugëtimi

18-vjeçar si vend anëtar i Aleancës, gjatë të cilit Forcat e Armatosura kanë kaluar një proces të thellë transformimi, modernizimi dhe integrimi në strukturat euroatlantike.

Nga një vend që dikur kishte si objektiv përmbushjen e standardeve bazë të NATO-s, Shqipëria është sot një aleate që kontribuon në misione ndërkombëtare, merr pjesë në stërvitje shumëkombëshe, investon në modernizimin e kapaciteteve ushtarake dhe angazhohet në ndërtimin e sigurisë kolektive. Pikërisht ky evolucion ka bërë që Tirana të fitojë besimin e Aleancës për të organizuar ngjarjen më të rëndësishme politike dhe ushtarake të NATO-s.

Organizimi i Samitit do të kërkojë një angazhim të jashtëzakonshëm institucional.

Përgatitjet nuk kufizohen vetëm në aspektin protokollar. Ato përfshijnë planifikimin operacional, garantimin e sigurisë së delegacioneve, koordinimin ndërinstitucional, menaxhimin e infrastrukturës, mbështetjen logjistike dhe aktivizimin e një game të gjerë kapacitetesh civile e ushtarake.

Në këtë proces, Forcat e Armatosura do të kenë një rol të rëndësishëm, duke bashkëpunuar ngushtë me strukturat e NATO-s dhe institucionet kombëtare për të garantuar standardet më të larta të sigurisë.

FORCAT E ARMATOSURA NË NJË ETAPË TË RE MODERNIZIMI

Vendimet e marra në Ankara pritet të ndikojnë drejtpërdrejt edhe në ritmin e zhvillimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

Rritja e investimeve në mbrojtje nuk nënkupton vetëm shtim të buxhetit. Ajo synon zhvillimin e kapaciteteve që i përgjigjen sfidave të reja të sigurisë.

Në vitet e ardhshme pritet të marrin përparësi modernizimi i sistemeve të komandim-kontrollit, mbrojtja ajrore, mbrojtja kibernetike, inteligjenca ushtarake, logjistika, infrastruktura strategjike dhe rritja e gatishmërisë operationale të njësive.

Një tjetër prioritet mbetet investimi te faktori njerëzor. Përgatitja profesionale e personelit ushtarak, arsimi ushtarak, stërvitjet e përbashkëta me aleatët dhe rritja e ndërveprueshmërisë do të vijnë në shtyllat kryesore të transformimit të Forcave të Armatosura.

Kjo filozofi përpunet plotësisht me objektivat e NATO-s për ndërtimin e forcave më të lëvizshme, më teknologjike dhe më të gatshme për të reaguar ndaj çdo situatë krize.

NJË MESAZH I QARTË PËR SIGURINË KOLEKTIVE

Samiti i Ankarasë konfirmoi se Aleanca po hyn në një fazë të re strategjike. Kërcënimet tradicionale tashmë shoqërohen me sulme hibride, dezinformim, ndërhyrje kibernetike, sabotim të infrastrukturës kritike dhe përdorim gjithnjë e më të madh të teknologjive të avancuara.

Për këtë arsye, vendet anëtare vendosën të forcojnë jo vetëm kapacitetet ushtarake klasike, por edhe mbrojtjen në hapësirën kibernetike, reziliencën kombëtare dhe aftësinë për t’u përgjigjur ndaj krizave shumëdimensionale.

Në deklaratimet e tij për mediat, Sekretari i Përgjithshëm Mark Rutte ritheksoi se NATO mbetet organizata më e fuqishme e mbrojtjes kolektive në botë dhe se uniteti ndërmjet aleatëve është garancia më e madhe për ruajtjen e paqes. Ai nënvizoi se debatet dhe dallimet e mendimeve nuk e dobësojnë Aleancën, por e bëjnë atë më funksionale dhe më të aftë për të marrë vendime strategjike.

SHQIPËRIA SI FAKTOR STABILITETI NË RAJON

Përzgjedhja e Tiranës si mikpritëse e Samitit të vitit 2027 është një mesazh i qartë edhe për rajonin e Ballkanit Perëndimor. Në një kohë kur stabiliteti rajonal mbetet një prioritet i NATO-s, Shqipëria shihet si një partner i besueshëm, një vend me orientim të palëkundur euroatlantik dhe një kontribuues aktiv në sigurinë rajonale.

Kontributi i Forcave të Armatosura shqiptare në misionet ndërkombëtare, pjesëmarrja në strukturat e Aleancës dhe investimet e vazhdueshme në mbrojtje kanë rritur profilin e vendit tonë brenda NATO-s. Samiti i vitit 2027 pritet të shërbejë edhe si një mundësi për të prezantuar zhvillimet e Shqipërisë në fushën e mbrojtjes, potencialin e saj strategjik dhe rolin që vendi ynë luan në garantimin e stabilitetit në krahun juglindor të Aleancës.

NJË RRUGËTIM QË VAZHDON....

Nga Samiti i Ankarasë doli qartë se NATO po përgatitet për një etapë të re të historisë së saj. Vendimet për rritjen e investimeve, modernizimin e kapaciteteve dhe forcimin e mbrojtjes kolektive janë përgjigje ndaj sfidave të një bote që ndryshon me shpejtësi.

Për Shqipërinë, ky samit do të mbahet mend jo vetëm për vendimet strategjike që u morën, por edhe sepse hapi zyrtarisht rrugën drejt një momenti historik për vendin tonë: **organizimin e Samitit të NATO-s në Tiranë.**

Ky është një vlerësim për institucionet shqiptare, për Forcat e Armatosura dhe për kontributin që Shqipëria ka dhënë gjatë viteve si aleate e besueshme.

Nga anëtarësimi në NATO në vitin 2009 deri te mikpritja e samitit më të rëndësishëm të Aleancës në vitin 2027, Shqipëria ka dëshmuar se është një partnere serioze, e përgjegjshme dhe e angazhuar për mbrojtjen e vlerave euroatlantike.

Samiti i Tiranës nuk do të jetë thjesht një ngjarje kalendarike. Ai do të jetë dëshmi e pjekurisë institucionale të vendit, e rolit në rritje të Forcave të Armatosura dhe e vendit që Shqipëria ka fituar në arkitekturën e sigurisë së NATO-s.





KONTRIBUTI I FORCAVE TË ARMATOSURA FORCON ROLIN E SHQIPËRISË NË NATO

**Shqipëria riafirmon angazhimin në NATO,
Tirana përgatitet të mirëpresë Samitin 2027**

Ankara, Turqi – Delegacioni shqiptar, i kryesuar nga kryeministri Edi Rama, me pjesëmarrjen e ministrit të Mbrojtjes, **Ermal Nufi** dhe shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, gjenerallejtënant **Arben Kingji**, mori pjesë në punimet e Samitit të 36-të të NATO-s, ku aleatët riafirmuan angazhimin e tyre të palëkundur për forcimin e mbrojtjes kolektive, rritjen e investimeve në mbrojtje, modernizimin e kapaciteteve ushtarake dhe vijimin e mbështetjes afatgjatë për Ukrainën.

Në deklaratën përfundimtare të samitit u ritheksua përkushtimi i Aleancës për forcimin e sigurisë euroatlantike, përballimin e kërcënimeve të reja dhe ruajtjen e paqes e stabilitetit përmes bashkëpunimit dhe solidaritetit ndërmjet vendeve anëtare.

Samiti solli gjithashtu një lajm me rëndësi të veçantë për Shqipërinë, pasi u konfirmua se vendi ynë do të mirëpresë Samitin e ardhshëm të NATO-s, në vitin 2027. Ky vendim përbën një vlerësim të lartë për rolin e Shqipërisë si një aleate e besueshme dhe kontribuuese aktive në Aleancë, si dhe dëshmi të besimit të partnerëve ndaj angazhimit të saj në përmbushjen e objektivave të përbashkëta të sigurisë.

Në kuadër të aktivitetit, ministri i Mbrojtjes, Ermal Nufi, mori pjesë edhe në pritjen joformale të organizuar nga ministri i Mbrojtjes Kombëtare të Turqisë, **Yaşar Güler**, për ministrat e mbrojtjes të vendeve aleate të NATO-s. Takimi shërbeu si një mundësi për shkëmbimin e pikëpamjeve mbi zhvillimet aktuale të sigurisë dhe forcimin e mëtejshëm të bashkëpunimit ndërmjet vendeve anëtare.

Duke vlerësuar rëndësinë e këtij takimi, ministri Nufi u shpreh se ai shërbeu për të forcuar marrëdhëniet mes aleatëve, për të diskutuar mbi sfidat e sigurisë dhe për të riafirmuar rëndësinë e bashkëpunimit, solidaritetit dhe unitetit në kuadër të NATO-s.

Pjesëmarrja e delegacionit shqiptar në Samitin e Ankarasë dhe konfirmimi i Tiranës si mikpritëse e Samitit të NATO-s, në vitin 2027, dëshmojnë rolin gjithnjë e më të rëndësishëm të Shqipërisë në arkitekturën e sigurisë euroatlantike dhe angazhimin e saj të vazhdueshëm për forcimin e mbrojtjes kolektive dhe stabilitetit rajonal.



Kryeministri Rama inauguron Shkollën Kombëtare të Fluturimit, një investim strategjik për modernizimin e Forcës Ajrore dhe fuqizimin e kapaciteteve mbrojtëse të vendit

Me pjesëmarrjen e kryeministrit **Edi Rama**, ministrit të Mbrojtjes **Ermal Nufi**, shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, gjenerallejtënant **Arben Kingji**, drejtuesve të lartë të Forcave të Armatosura, partnerëve ndërkombëtarë dhe 25 kandidatëve të parë, në Komandën e Forcës Ajrore në Rinas u zhvillua ceremonia e inaugurimit të **Shkollës Kombëtare të Fluturimit**, një investim me rëndësi strategjike për zhvillimin e kapaciteteve ajrore të Republikës së Shqipërisë.

Hapja e kësaj shkolle shënon një etapë të re në modernizimin e Forcës Ajrore dhe përfaqëson një tjetër hap konkret në transformimin e Forcave të Armatosura sipas standardeve të NATO-s. Projekti synon krijimin e një sistemi kombëtar për formimin e pilotëve dhe kontrollorëve të fluturimit, duke garantuar përgatitje profesionale me teknologji moderne dhe metodologjitë më bashkëkohore të aleatëve.

Në fjalën e tij, ministri i Mbrojtjes, **Ermal Nufi**, e cilësoi Shkollën Kombëtare të Fluturimit si një investim që shkon përtej ndërtimit të një strukture të re arsimore.

“Ne nuk po përurojmë thjesht një strukturë të re arsimimi apo trajnimi, por po hedhim një tjetër gur themeli në fuqizimin e kapaciteteve të Forcës sonë Ajrore të së ardhmes. Po krijojmë një kapacitet të ri strategjik për mbrojtjen dhe sigurinë kombëtare, të lidhur drejtpërdrejt me zhvillimin e burimeve njerëzore”, - u shpreh ministri Nufi.

Ai theksoi se shkolla do të përgatisë pilotë dhe kontrollorë fluturimi sipas standardeve të Aleancës, ndërsa një rol të rëndësishëm në procesin e trajnimit do të kenë edhe dy helikopterët e rinj **“Bell 505”**, tashmë pjesë e inventarit të Forcës Ajrore, të cilët do të shërbejnë si platformë moderne për formimin e brezit të ri të pilotëve ushtarakë.

Ministri Nufi nënvizoi se investimet në infrastrukturë, teknologji dhe, mbi të gjitha, në zhvillimin e burimeve njerëzore janë pjesë e strategjisë afatgjatë të modernizimit të Forcave të Armatosura dhe të forcimit të rolit të Shqipërisë si një aleate e besueshme në NATO.

Ceremonia shënoi edhe nisjen zyrtare të aktivitetit të Shkollës Kombëtare të Fluturimit, ku u mirëpritën **25 kandidatët e parë**, të cilët do të ndjekin programin e formimit për pilotë dhe kontrollorë të fluturimit.

Sipas planifikimit të Forcës Ajrore, shkolla do të përgatisë **pesë pilotë të rinj çdo vit gjatë pesë viteve të ardhshme**, si dhe personel teknik të specializuar për mirëmbajtjen e helikopterëve mësimorë **“Bell 505”**, duke krijuar një bazë të qëndrueshme për zhvillimin e kapaciteteve ajrore të vendit.

Inaugurimi i Shkollës Kombëtare të Fluturimit përfaqëson një tjetër hap të rëndësishëm në rrugën e modernizimit të Forcave të Armatosura, duke investuar te personeli, teknologjia dhe aftësitë që garantojnë mbrojtjen e hapësirës ajrore dhe përmbushjen e angazhimeve të Shqipërisë në kuadër të NATO-s.



Kryeministri Rama inauguron Shkollën Kombëtare të Fluturimit: NJË INVESTIM STRATEGJIK PËR TË ARDHMEN E FORCËS AJRORE DHE FORCAVE TË ARMATOSURA



Artiljerët shqiptarë trajnohen në Turqi për top-obusin 105 mm BORAN

ANKARA – Në kuadër të Planit të Bashkëpunimit ndërmjet Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë dhe Forcave të Armatosura të Republikës së Turqisë, efektivë të Batalionit të Artilerisë Tokësore të Regjimentit të Mbështetjes së Luftimit zhvilluan në Ankara një trajnim të specializuar mbi përdorimin dhe mirëmbajtjen e top-obusit 105 mm **BORAN**.

Gjatë këtij trajnimi, personeli shqiptar përfitoi njohuri teorike dhe praktike mbi procedurat e përdorimit, mirëmbajtjes dhe shfrytëzimit operacional të sistemit të artilerisë BORAN, duke rritur nivelin e përgatitjes profesionale në përputhje me standardet bashkëkohore të vendeve aleate.

Trajnimi shërbeu gjithashtu për forcimin e kapaciteteve të zjarrit të Forcës Tokësore, rritjen e gatishmërisë operationale dhe zgjerimin e ndërveprueshmërisë me forcat partnere të NATO-s, duke kontribuar në përmbushjen e objektivave të përbashkëta në fushën e mbrojtjes. Përgatitja profesionale dhe kualifikimi i vazhdueshëm i efektiveve mbeten një ndër prioritetet kryesore të Forcave të Armatosura, si pjesë e procesit të modernizimit dhe zhvillimit të kapaciteteve ushtarake, në funksion të mbrojtjes së vendit dhe përmbushjes së angazhimeve të Republikës së Shqipërisë në kuadër të NATO-s.



Regjimenti i Këmbësores së Veriut nis kontingjentin e radhës në misionin e NATO-s

Forca Tokësore përcolli kontingjentin e radhës të Regjimentit të Këmbësores së Veriut (RKV), i cili do të marrë pjesë në misionin e NATO-s **Forward Land Forces (FLF)**, të dislokuar në Novo Selo, Bullgari. Ushtarakët shqiptarë nisen drejt misionit me një nivel të lartë përgatitjeje profesionale, gatishmërie dhe përkushtimi, për të kontribuar në forcimin e mbrojtjes kolektive të Aleancës dhe në rritjen e sigurisë në krahun lindor të NATO-s, përkrah forcave të vendeve aleate. Pjesëmarrja në këtë mision përfaqëson një tjetër angazhim konkret të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në mbështetje të objektivave të Aleancës, duke dëshmuar besueshmërinë, profesionalizmin dhe ndërveprueshmërinë e personelit ushtarak shqiptar në operacionet shumëkombëshe.

Me dislokimin e këtij kontingjenti, Forca Tokësore vijon të konfirmojë rolin e saj aktiv në operacionet dhe aktivitetet e NATO-s, duke kontribuar në



ruajtjen e paqes, sigurisë dhe stabilitetit rajonal, si dhe në përmbushjen e angazhimeve që Shqipëria ka marrë si vendanëtar i Aleancës. Në ceremoninë e për-

cjelljes, efektiveve iu uruan suksese në përmbushjen e misionit dhe një kthim të sigurt në atdhe, pas përfundimit me sukses të detyrës së besuar.





ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Ka një fotografi që flet më shumë se një mijë statistika. Në të nuk shoh vetëm buzëqeshje, kostume të shtrenjta, limuzina, makina luksoze, fustane që kushtojnë sa paga mujore e një familjeje apo fishekzjarre që ndriçojnë qiellin për pak minuta. Shoh një shoqëri që, pa e kuptuar, po edukon brezin e saj më të ri se vlera matet me çmimin.

Dhe kjo është arsyeja pse mbrëmjet e maturës, por tashmë edhe festimet e nxënësve të klasave të nënta, nuk janë më thjesht ceremoni përmbyllëse të një etape shkollore. Ato janë shndërruar në një skenë ku ekspozohet statusi ekonomik, ku krahasimi është bërë pjesë e ritualit dhe ku emocioni i ndarjes nga banka e shkollës po zëvendësohet nga ankthi për të mos dalë “më pak” se të tjerët.

Është një ndryshim që nuk ndodhi brenda natës.

Pak vite më parë, matura kujtohej për emocionet, për foton e klasës, për përqaftimet me mësuesit dhe premtimet se miqësitë do të vazhdonin. Sot, në shumë raste, bisedat nisin me pyetje krejt të tjera: **Sa kushtoi fustani? Çfarë marke është kostumi? Me çfarë makine do të mbërrijë? Kush e ka rezervuar lokalin më të shtrenjtë? Kush ka artistin më të njohur? Kush bëri hyrjen më spektakolare?**

Në momentin që këto pyetje bëhen më të rëndësishme sesa vetë përfundimi i shkollës, kemi hyrë në një territor ku arsimit humbet përballë konsumizmit.

Paradoksi është i madh.

Kjo është ceremonia që duhet të simbolizojë përfundimin e një rrugëtimi dijetsh, sakrificash dhe formimi. Por gjithnjë e më shpesh ajo po matet me standarde që nuk kanë asnjë lidhje me dijen.

Në vend që të festojmë atë që një i ri ka mësuar, festojmë atë që familja e tij ka mundur të blejë. **Në vend që të vlerësojmë karakterin, admirojmë markën. Në vend që të kujtojmë mësuesit, fotografojmë makinat.**

Kjo nuk është më një festë e arsimit. Është një ekspozitë e konsumit.

Fenomeni nuk duhet parë vetëm si çështje estetike. Ai ka pasoja sociale shumë më të thella.

Në një klasë ku jo të gjithë kanë të njëjtat mundësi ekonomike, gara për luks krijon ndarje të padukshme. Ka nxënës që ndihen të detyruar t’u kërkojnë prindërve shpenzime që familja nuk i përballon. Ka prindër që marrin borxhe vetëm për të mos ia “ulur kokën” fëmijës. Ka të rinj që e përjetojnë festën me stres, jo me gëzim, sepse ndihen të përjashtuar nga standardi që vetë shoqëria ka krijuar.

Kur një natë zgjat vetëm disa orë, por faturat paguhen për muaj të tërë, duhet të pyesim veten: **kush po feston në të vërtetë?**

Në këtë garë nuk humbet vetëm xhepi. Humbet vetë kuptimi i festës.

Mbrëmja e maturës nuk është një konkurs mode. Nuk është një ekspozitë automobilash. Nuk është një reklamë markash.

Ajo duhet të jetë kujtesa më e bukur e një moshe që nuk kthehet më.

“MATURANTËT E LUKSIT”: Kur matura bëhet pasarelë dhe sakrifica mbetet jashtë fotos



qytetarë që do ta kërkojnë gjithmonë vlerën jashtë vetes.

Nërkohë, harrojmë të shtrojmë pyetjet më të rëndësishme...

Sa libra lexoi ky maturant? Çfarë ëndrrash ka? Çfarë do të ndërtojë për vendin e tij? Çfarë karakteri ka formuar?

Këto janë pyetje që nuk bëhen virale. Nuk marrin mijëra pëlqime.

Por janë ato që përcaktojnë të ardhmen e një kombi.

Sigurisht, askush nuk është kundër festës. Askush nuk kërkon që të rinjtë të mos gëzojnë ditën e tyre. Përkundrazi. Ata e meritojnë.

Problemi lind kur festa bëhet garë. Kur emocioni zëvendësohet nga demonstrimi. Kur kujtimi zëvendësohet nga reklama. Kur modestia shihet si varfëri dhe thjeshtësia si dështim.

Shoqëria shqiptare ka kaluar periudha të vështira për të arritur standarde më të mira jetese. Është normale që familjet të duan t’u japin fëmijëve më shumë sesa kanë pasur vetë. Por ekziston një kufi i hollë mes dëshirës për t’i bërë të lumtur dhe nevojës për të impresionuar të tjerët.

Ky kufi po bëhet çdo vit e më i padukshëm.

Në fund të fundit, askush nuk do ta kujtojë pas dhjetë vitesh sa kushtonte fustani. Askush nuk do të kujtojë çmimin e makinës. Askush nuk do të kujtojë markën e këpucëve. Por të gjithë do të kujtojnë shokët e klasës. Mësuesin që i frymëzoi. Përqaftimin e fundit. Lotët e ndarjes. Fotografinë ku buzëqeshja ishte e vërtetë dhe jo e kuruar nga filtrat.

Nëse duam që brezi i ri të ndërtojë një shoqëri më të drejtë, duhet t’i japim modele të tjera suksesi.

Duhet t’u tregojmë se eleganca nuk është çështje çmimi, por kulture; se dinjiteti nuk vishet me marka; se respekti nuk fitohet me luks, por me karakter.

Matura është një prag. Nga ajo derë të rinjtë hyjnë në jetën e rritur. Do të ishte tragjike që mesazhi i parë që u japim në këtë prag të jetë: “Vlera jote është aq sa kushton ceremonia jote”.

Sepse, nëse kjo bëhet filozofia e brezit të ri, atëherë nuk kemi luksuar vetëm një mbrëmje.

Kemi varfëruar një sistem vlerash.

Dhe kjo është një faturë shumë më e shtrenjtë se çdo fustan, çdo limuzinë apo çdo banket luksoz.

Një komb nuk ndërtohet nga spektakli i një nate. Ai ndërtohet nga karakteri që mbetet pasi dritat e festës janë fikur.

Fatkeqësisht, rrjetet sociale kanë ushqyer edhe më shumë këtë fenomen. Një fotografi nuk mjafton më. Duhet video profesionale, hyrje kinematografike, dronë, efekte speciale, koreografi, skenar dhe publikime që zgjasin javë të tëra.

Në fund, duket sikur ceremonia nuk organizohet për ata që marrin pjesë, por për ata që do ta shohin në ekran.

Jeta reale është kthyer në skenografi për botën virtuale.

Edhe më shqetësues është fakti se i njëjti model po zbrit në mosha gjithnjë e më të vogla. Dikur këto ekzagjerime lidhen vetëm me maturën. Sot ato shihen edhe në ceremonitë e klasave të nënta. Nesër, ndoshta, do të shfaqen edhe në fund të ciklit fillor.

Po edukojmë fëmijët që çdo etapë e jetës duhet të shoqërohet me luks, spektakël dhe shpenzim. Por askush nuk po i mëson se gëzimi nuk blihet.

Një shoqëri që i mëson të rinjtë të matin veten me markën e kostumit ose me modelin e makinës, rrezikon të krijojë

ANJEZA MUSOLLARI,
Shefë e Sektorit të Botimeve

KUR FËMIJËT FILMOJNË DHUNËN, SHOQËRIA
DUHET TË FILMOJË NDËRGJEGJEN E SAJ

Çfarë po ndodh me të rinjtë shqiptarë?

Ka ngjarje që nuk zgjasin më shumë se disa minuta, por tronditin një shoqëri për vite me radhë. Ka pamje që nuk duhen transmetuar në televizion, jo sepse janë të papërshtatshme, por sepse janë një akuzë e rëndë ndaj të gjithëve ne. Dhe ka britma që nuk dëgjohen vetëm nga një vajzë e dhunuar, por nga vetë ndërgjegjja e një kombi.

Ngjarja e Fierit nuk është thjesht një kronikë policore. Nuk është një konflikt mes adoleshentësh. Nuk është një zënkë që doli jashtë kontrollit. Është një kampanë alarmi që bie fort për familjen shqiptare, për shkollën, për institucionet, për median dhe për secilin prej nesh.

Një vajzë shtatëmbëdhjetëvjeçare u mashtrua me premtimin e një “surprize”, u çua në një banesë të huaj, u izolua dhe u dhunua nga tri bashkëmoshatare. Ajo ishte vetëm. Përballë kishte tre vajza që nuk mjaftoheshin ta godisnin. Ato kishin ndezur kamerën e telefonit. Donin ta regjistronin dhunën. Donin ta ruanin si trofe. Donin ta shpërndanin si spektakël.

Ky është momenti kur nuk mund të flasim më vetëm për bullizëm.

Kjo është humbje e ndjeshmërisë njerëzore.

Është çasti kur dhimbja e tjetrit nuk të pengon më të qeshësh. Përkundrazi, bëhet arsye për të fituar vëmendje, klikime, miratim nga një rreth shoqëror që ushqehet me poshtërimin e më të dobët.

Nëse dikur dhuna fshihej nga turpi, sot ajo ekspozohet për famë.

Kjo është tragjedia jonë.

Pyetja që duhet t'i bëjmë vetes nuk është vetëm: “Pse ndodhi?” Pyetja është shumë më e rëndë. Çfarë kemi bërë ne që një vajzë pesëmbëdhjetëvjeçare ta konsiderojë normale të godasë një bashkëmoshatare, ndërsa një tjetër ta filmojë me buzëqeshje?

Kjo nuk lind brenda një dite. As brenda një jave. Dhuna nuk lind në momentin kur ngrihet dora. Ajo lind shumë më herët. Lind në një familje ku mungon dialogu. Lind në një shkollë ku fëmija nuk dëgjohet. Lind në një shoqëri ku suksesi matet me dominimin mbi tjetrin. Lind në ekranet ku poshtërimi shndërrohet në argëtim. Lind në rrjetet sociale ku fyerja merr mijëra pëlqime dhe mirësia shpesh kalon pa u vënë re.

Sot fëmijët tanë po rriten në një botë ku kamera është gjithmonë ndezur, por ndërgjegjja shpesh është fikur.

Një detaj i kësaj ngjarjeje dhemb më shumë se çdo tjetër. Vajza e dhunuar nuk shkoi menjëherë te nëna. Ajo shkoi vetëm në spital.

Vetëm.

Me serum në dorë. Me fytyrë të nxirë. Me flokë të shkulur. Me shpirt të copëtuar.

Kur nëna e pyeti: “Kush ta bëri këtë?”, ajo u përpoq ta fshihte. Sepse viktimat shpesh kanë turp.

Turpi nuk është i tyre.

Turpi është i shoqërisë që i ka lënë të pambrojtura.

Fjalët e nënës janë ndoshta editoriali më i dhimbshëm që mund të shkruhej.

“Kam një muaj që nuk fle”, “Nuk qaj para vajzës”, “Ajo më kërkonte ndihmë dhe unë nuk isha pranë”. Këto nuk janë vetëm fjalët e një nëne. Janë britma e mijëra prindërve shqiptarë që jetojnë çdo ditë me frikën se mos fëmija i tyre bëhet viktimë e një bote gjithnjë e më të egër.

Sepse askush nuk mendon se tragjedia do t'i trokasë në derë.

Derisa ajo troket.

Shqipëria ka ndryshuar me shpejtësi. Teknologjia ka hyrë në çdo familje. Telefonat inteligjentë janë bërë pjesë e fëmijërisë.

Por edukimi emocional nuk ka ecur me të njëjtin ritëm.

Fëmijët dinë të përdorin aplikacionet më të sofistikuar. Por shumë prej tyre nuk dinë të menaxhojnë zemërimin. Dinë të bëjnë video. Por nuk dinë të ndalojnë dhunën. Dinë të krijojnë profile. Por nuk dinë të ndërtojnë karakter. Ky është paradoksi i kohës sonë.

Po rrisim një brez që komunikon pa pushim, por dëgjon gjithnjë e më pak.

Një brez që është vazhdimisht “online”, por shpesh ndihet i vetmuar.

Një brez që ka qindra ndjekës në rrjetet sociale, por gjithnjë e më pak miq të vërtetë.

Nuk mund ta fajësojmë vetëm internetin. Interneti nuk edukon. As telefoni.

As TikTok-u. Ata janë mjete. Karakterin e ndërton familja. Vlerat i kultivon shkolla. Ndërgjegjen e formon shoqëria. Nëse këto hallka dobësohen, boshllëkun e mbush dhuna. Dhe pikërisht këtë po shohim sot. Jo vetëm në Fier. Por në shumë qytete të Shqipërisë. Në shumë shkolla. Në shumë familje që heshtin. Heshtja është bërë aleatja më e rrezikshme e dhunës.

Kur prindërit humbasin gjurmët e fëmijëve të tyre

Shpesh, pas çdo ngjarjeje të rëndë, dëgjojmë të njëjten fjalë: *“Ishte fëmijë i mirë...”*, *“Nuk e prisnim...”*, *“Nuk kishte shfaqur probleme...”*. Por a mjafton kjo?

Në një kohë kur fëmijët kalojnë më shumë orë me telefonin sesa duke biseduar me prindërit, pyetja që duhet të bëjmë është tjetër: A i njohim vërtet fëmijët tanë? A dimë kush janë shokët e tyre? A dimë çfarë shohin në telefon? Kë ndjekin në rrjetet sociale? Çfarë i bën të qeshin? Çfarë i tremb? Çfarë i zemëron?

Kur ishte hera e fundit që një prind u ul përballë fëmijës pa telefon në dorë dhe e pyeti thjesht: *“Si je?”*. Jo për notat. Jo për mungesat. Jo për disiplinën.

Por për shpirtin e tij.

Sepse plagët më të rrezikshme nuk janë ato që shihen në fytyrë.

Janë ato që fëmijët i mbajnë të fshehura.

Një fëmijë që nuk ndihet i dëgjuar në shtëpi, do të kërkojë të dëgjohet diku tjetër.

KUSH PO UA VRET FËMIJËRINË FËMIJËVE TANË?

Kur dhuna filmohet për argëtim, nuk kemi më vetëm një viktimë, kemi një shoqëri që duhet të zgjohet



Dhe jo gjithmonë do të gjejë njerëzit e duhur.

Shkolla nuk mund të jetë vetëm

vendi ku mësohen formulat

Nëse dikur shkolla ishte institucioni ku formohej karakteri, sot ajo rrezikon të kufizohet vetëm në dhënien e dijes.

Por një shoqëri nuk ndërtohet vetëm me nxënës që dinë matematikë apo gjuhë të huaja.

Ajo ndërtohet me qytetarë. Me njerëz që respektojnë tjetrin. Me të rinj që dinë të kontrollojnë zemërimin. Me vajza dhe djem që kuptojnë se forca nuk matet me grushte. Mësuesit nuk mund të jenë vetëm transmetues njohurish. Ata janë edukatorë. Ata janë njerëzit që shpesh kalojnë më shumë kohë me fëmijët sesa vetë prindërit. Prandaj nuk duhet të mjaftojë vetëm evidentimi i një konflikti. Duhet parandaluar ai.

Psikologët shkollorë nuk duhet të jenë një emër në organikë. Ata duhet të jenë të pranishëm në jetën e përditshme të nxënësve. Bullizmi nuk fillon me grushtin e parë.

Ai fillon me talljen. Me përjashtimin. Me fyerjen. Me videon që qarkullon në grup. Me heshtjen e klasës.

Institucionet nuk mund të mbërrijnë

gjithmonë pasi tragjedia ka ndodhur

Policia bëri detyrën e saj. Prokuroria nisi hetimet. Ligji do të ndjekë rrugën e tij.

Por a mjafton kjo?

Jo.

Sepse drejtësia vepron pasi dëmi është bërë. Ndërsa shteti duhet të jetë i pranishëm përpara se dhuna të ndodhë. Shqipëria ka nevojë për një strategji kombëtare kundër bullizmit. Jo vetëm dokumente. Por veprim. Trajnime për mësuesit. Mbështetje për familjet. Psikologë në çdo shkollë. Fushata ndërgjegjësimi. Mekanizma raportimi që funksionojnë. Asnjë fëmijë nuk duhet të ketë frikë të tregojë se po dhunohet. Dhe asnjë prind nuk duhet të ndihet i vetëm përballë një tragjedie të tillë.

Rrjetet sociale nuk duhet të jenë gjykata e brezit të ri

Fenomeni më shqetësues i kësaj historie nuk është vetëm dhuna. Është fakti se ajo u filmua. Kjo tregon se për një pjesë të të rinjve kamera nuk është më mjet kujtese. Është mjet pushteti. Sa më shumë poshtërohet viktimja, aq më shumë vëmendje kërkon autori. Ky është një model i rrezikshëm që ushqehet çdo ditë nga përmbajtje ku dhuna, fyerja dhe poshtërimi shndërrohen në spektakël. Shoqëria shqiptare duhet të mësojë t'u thotë fëmijëve një të vërtetë të thjeshtë: Jo çdo gjë që bëhet virale është vlerë. Shpesh bëhet virale pikërisht ajo që tregon varfërinë morale të një shoqërie.

Kjo nuk është luftë mes fëmijësh. Është luftë për shpirtin e brezit të ri.

Kur një vajzë goditet nga tri të tjera, humbet viktimja. Kur kjo dhunë filmohet, humbin autorët. Kur videoja shpërndalet, humbet shoqëria. Sepse në atë moment nuk kemi më të bëjmë vetëm me një vepër penale. Kemi të bëjmë me një krizë të thellë vlerash. **Nëse sot nuk reagojmë, nesër do të kemi më shumë kamera që regjistrojnë dhunën dhe më pak njerëz që e ndalojnë atë.**

Një apel për të gjithë

Ky editorial nuk është shkruar për të gjykuar tre vajza. Ato do të përballen me ligjin dhe me institucionet përkatëse. Ky editorial është shkruar për të zgjuar ndërgjegjen tonë. Për t'u kujtuar prindërve se edukimi fillon në shtëpi. Për t'u kujtuar mësuesve se çdo nxënës ka nevojë të dëgjohet. Për t'u kujtuar institucioneve se parandalimi është më i rëndësishëm se ndëshkimi. Për t'u kujtuar të rinjve se forca nuk qëndron te dhuna, por te karakteri.

Dhe për t'u kujtuar secilin prej nesh se një shoqëri nuk

matet me ndërtesat që ngre, por me mënyrën se si mbron fëmijët e saj. Sepse sot ishte një vajzë në Fier.

Nesër mund të jetë fëmija i kujtdo. Nëse vazhdojmë të heshtim, nuk do të jemi vetëm dëshmitarë të kësaj dhune. Do të bëhemi bashkëfajtorë të saj.

Shoqëria shqiptare nuk ka nevojë vetëm për kampionë, për influencues apo për të rinj që shkëlqejnë në rrjetet sociale.

Ka nevojë për një brez që di të respektojë, të ndihmojë, të mbrojë dhe të zgjasë dorën ndaj atij që është më i dobët. Sepse vetëm atëherë mund të themi se kemi ndërtuar një Shqipëri më të sigurt, më njerëzore dhe më të denjë për brezat që do të vijnë.

Sot, nuk po e mbyll këtë editorial vetëm si gazetarë. Po e mbyll si nënë.

Sepse përballë kësaj ngjarjeje nuk mjafton profesionalizmi. Nuk mjafton të raportosh faktet, të numërosh goditjet, të citosh ligjin apo të presësh vendimin e drejtësisë. Ka momente kur çdo nënë e çdo baba ndien se i është prekur vetë zemra.

Teksa shihja rrëfimin e asaj vajze, mendoja vetëm një gjë: **po sikur të ishte vajza ime?** Po sikur ajo të më kërkonte ndihmë me britma dhe unë të mos isha pranë? Po sikur ta përqafoja vetëm pasi dikush ia kishte thyer besimin, dinjitetin dhe sigurinë?

Nuk dua ta besoj se po rrisim një brez që e quan forcë poshtërimin e tjetrit. Nuk dua ta besoj se kemi arritur në pikën ku një telefon ndizet më shpejt për të filmuar dhunën sesa një dorë zgjatet për ta ndaluar atë. Nuk dua ta besoj se fëmijët tanë po mësojnë të qeshin me lotët e një bashkëmoshatari.

Por kjo po ndodh.

Dhe nëse vazhdojmë ta quajmë **“një rast të izoluar”**, nesër do të zgjohemi në një shoqëri ku i izoluar do të jetë vetëm ai fëmijë që ende di të jetë i mirë.

U bëj thirrje prindërve: mos u mjaftoni duke pyetur fëmijët tuaj ku ishin. Pyetini **si ndihen**, kë kanë pranë, kë admirojnë, çfarë i lëndon dhe çfarë i bën të zemëruar. Edukimi nuk është vetëm të sigurosh bukën e përditshme; është të ushqesh zemrën, karakterin dhe ndërgjegjen e tyre.

U bëj thirrje mësuesve: vazhdoni të mësoni matematikë, gjuhë e shkencë, por mos harroni të mësoni edhe respektin, mirësinë dhe përgjegjësinë. Ndonjëherë një fjalë e ngrohtë e një mësuesi shpëton një fëmijë nga vetmia.

U bëj thirrje institucioneve: mos prisni tragjedinë e radhës për të reaguar. Çdo fëmijë që humbet besimin te shoqëria është një alarm që nuk duhet të injorohet.

Dhe ju, të rinj që do ta lexoni këtë: mos e matni veten me numrin e ndjekësve, me videot që bëhen virale apo me frikën që u impononi të tjerëve. Njeriu i fortë nuk është ai që godet. Njeriu i fortë është ai që mbron. Është ai që ndalon dhunën, edhe kur të tjerët heshtin.

Si nënë, kam frikë. Kam frikë jo vetëm për fëmijën tim, por për çdo fëmijë të këtij vendi.

Kam frikë nga një shoqëri që po humbet aftësinë të ndiejë dhimbjen e tjetrit.

Por ende kam shpresë.

Kam shpresë se nuk jemi vonë. Se mund të zgjohemi. Se mund të rikthejmë njerëzoren përpara se urrejtja të bëhet normale.

Sepse Shqipëria që duam nuk ndërtohet vetëm me rrugë, ura e ndërtesa.

Ajo ndërtohet me fëmijë që dinë të respektojnë, me prindër që dinë të dëgjojnë, me mësues që dinë të frymëzojnë dhe me institucione që dinë të mbrojnë.

Dhe nëse sot nuk gjejmë forcën të mbrojmë një vajzë të pambrojtur, nesër nuk do të kemi më të drejtën morale të pyesim pse po humbasim brezin tonë.

Sepse fëmijët nuk lindin të dhunshëm. Ata bëhen të tillë kur të rriturit heshtin përballë dhunës. Dhe heshtja jonë, sot, mund të jetë plagë e Shqipërisë së nesërme.

ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Ka njerëz që nuk kërkojnë duartrokitje. Nuk dalin në skenë, nuk flasin me zë të lartë për betejat e tyre, por çdo ditë mbajnë peshën e botës mbi supe. Një prej tyre është gruaja.

Ajo grua që ka mbajtur plagët e brezave, që ka heshtur dhimbjet e saj për të ruajtur qetësinë e të tjerëve, që ka dhënë dashuri edhe kur vetë kishte nevojë të përqafohej. Ajo grua që ka qenë shtylla e familjes, mbështetja e të dobët, zëri i atyre që nuk mundën të flisnin.

Por edhe shtyllat lodhen.

Edhe duart që mbajnë gjithçka, një ditë kanë nevojë të pushojnë.

Lodhja e saj nuk është dobësi. Është dëshmi. Është gjurma e një rruge të gjatë të përshkuar me durim, sakrificë dhe një forcë të heshtur që shpesh shoqëria e ka marrë si të mirëqenë.

Një fotografi që tregon më shumë se mijëra fjalë

Ato flasin përmes heshtjes, përmes një shikimi të rënduar, përmes një trupi që mban një peshë të madhe, por ende qëndron në këmbë.

Figura e gruas që mban mbi shpinë një grumbull gurësh nuk është vetëm një pamje artistike. Është një metaforë e fuqishme për miliona gra në mbarë botën.

Gurët mbi shpinën e saj nuk janë thjesht gurë.

Ata janë vitet e sakrificës. Janë netët pa gjumë kur një nënë kujdeset për fëmijët, ndërsa harronte lodhjen e saj. Janë ëndrrat e shtyra për më vonë.

Janë përgjegjësitë e pranura pa ankesa. Janë fjalët e pathëna të grave që shpesh kanë zgjedhur të heshtin jo sepse nuk kishin çfarë të thoshin, por sepse mendonin se të tjerët kishin më shumë nevojë për to.

Kjo është historia e shumë grave: të japin gjithçka, shpesh pa pyetur nëse kanë mbetur diçka për veten.

Forca që nuk bërtet

Në një botë ku shpesh forca lidhet me zërin e lartë, pushtetin apo ndikimin e dukshëm, ekziston një tjetër lloj force. Forca e heshtur. Ajo forcë që nuk kërkon vëmendje, por që ndërton.

Gruaja ka qenë gjithmonë një nga themelet më të rëndësishme të shoqërisë. Ajo ka rritur breza, ka ruajtur familje, ka mbajtur gjallë tradita, ka luftuar për arsimimin, pavarësinë dhe dinjitetin e saj.

Pas shumë historive të suksesit, pas shumë familjeve të qëndrueshme dhe pas shumë brezave të edukuar, qëndron një grua që ka dhënë më shumë sesa është parë. Shpesh bota sheh rezultatin, por harron rrugën. Sheh buzëqeshjen, por jo lotët që janë fshehur pas saj. Sheh suksesin, por jo sakrificat që e kanë bërë të mundur.

Kur sakrifica bëhet barrë

Megjithatë, ekziston një pyetje që duhet t'ia bëjmë vetes si shoqëri: Sa gjatë mund t'i kërkojmë një gruaje të mbajë gjithçka? Sa gjatë mund të presim që ajo të jetë gjithmonë e fortë? Sa herë duhet t'i kujtojmë vetes se edhe ajo ka nevojë për mbështetje, kujdes dhe dashuri?

Shpesh grave u është mësuar të jenë të forta në çdo situatë. Të mos ankohen. Të mos dorëzohen. Të vendosin

Gruaja që Mbajti Botën mbi Supe, Por Harroi të Mbante Vetën



gjithmonë të tjerët përpara vetes.

Por të kujdesesh për veten nuk është egoizëm. Të pranosh lodhjen nuk është dobësi. Të kërkoksh ndihmë nuk të bën më pak të fortë.

Përkundrazi, është një shenjë e një vetëdijeje të madhe, edhe ata që mbajnë të tjerët, kanë nevojë që dikush t'i mbajë ndonjëherë.

Një shoqëri matet edhe me mënyrën si i trajton gratë

Sot flasim për barazi, për të drejta dhe për mundësi të njëjta. Por respekti për gruan nuk duhet të mbetet vetëm në fjalime apo në data simbolike.

Ai duhet të jetë pjesë e jetës së përditshme. Në familje. Në vendin e punës. Në komunitet. Në mënyrën se si dëgjojmë zërin e saj dhe vlerësojmë kontributin e saj. Një shoqëri nuk ndërtohet vetëm nga ligjet, institucionet apo strukturat e mëdha. Ajo ndërtohet edhe nga miliona veprime të vogla njerëzore: një fjalë mirënjohjeje, një ndihmë në momentin e duhur, një respekt i treguar çdo ditë.

Sepse shumë nga themelet e botës mbahen nga njerëz që nuk shfaqen në qendër të vëmendjes.

Ajo që mban botën, duhet të kujtojë edhe veten

Gruaja që mban botën mbi supe nuk është simbol i dobësisë. Ajo është simbol i qëndrueshmërisë. Ajo nuk ka lindur vetëm për të mbajtur barrë. Ajo ka lindur edhe për të jetuar. Për të ëndërruar. Për të dashur. Për të pasur kohë për veten.

Për të qenë më shumë sesa rolet që i ka dhënë shoqëria. Ndoshta ka ardhur koha që shumë gra të heqin nga supet ato peshat që nuk kanë qenë kurrë të tyre. Të lënë pas fajin që nuk u përket. Të përqafojnë veten me të njëjtën butësi që ua kanë dhënë të tjerëve.

Sepse shërimi fillon në momentin kur njeriu ndalon së humburi veten për të mbajtur gjithçka në këmbë.

Gruaja, Ajo që bie dhe ngrihet,
Ajo që lodhet dhe vazhdon

Bota nuk mbahet vetëm nga ata që kanë pushtet të dukshëm. Ajo mbahet edhe nga ata që mbajnë barrë të padukshme.

Nga nënat.

Nga vajzat.

Nga gratë që çdo ditë zgjedhin dashurinë përpara lodhjes.

Nga ato që ecin përpara edhe kur rruga është e vështirë.

Kur supet e një gruaje mbajnë më shumë se një jetë

Ajo grua nuk është thjesht dikush që mban gurë mbi shpinë. Ajo është historia e forcës njerëzore.

Dhe ndoshta pyetja që duhet t'i bëjmë vetes nuk është: “Sa shumë mund të mbajë një grua?”

Por: “Sa më shumë duhet të mbajë ajo, përpara se ne të fillojmë ta mbajmë edhe ne?”

Mos harro, gruaja që gjithmonë ka qenë aty për të gjithë, meriton që edhe dikush të jetë aty për të. Ajo që ka mbajtur lotët e të tjerëve, ka nevojë edhe për një dorë që ta mbajë atë. Ajo që ka dhënë dashuri pa masë, meriton të marrë dashuri po aq. Sepse një grua nuk është e fortë vetëm kur duron gjithçka. Ajo është e fortë edhe kur zgjedh veten, kur pushon, kur shërohet dhe kur kujton se edhe zemra e saj ka nevojë për kujdes.

Nderoni gruan jo vetëm për atë që ajo bën për botën, por edhe për atë që ajo është.



BOROVA 1943 - KUJTESA QË NA THËRRET TË MOS HARROJMË

80 vjet pas masakrës, dhimbja e 107 viktimave civile mbetet një dëshmi e krimeve të nazizmit dhe një mesazh universal kundër dhunës

Historia nuk mbahet gjallë vetëm nga librat. Ajo jeton përmes kujtesës së njerëzve, përmes vendeve ku kanë ndodhur tragjedi, përmes emrave të atyre që humbën jetën dhe përmes përgjegjesisë që brezat e rinj kanë për të mos lejuar përsëritjen e së keqes.

Një prej këtyre vendeve të kujtesës është Borova e Kolonjës.

Më 6 korrik 1943, ky fshat i qetë u kthye në skenën e një prej masakrave më të rënda të kryera ndaj popullsisë civile shqiptare gjatë Luftës së Dytë Botërore. Një krim që la pas 107 viktima të pafajshme, mes të cilëve gra, fëmijë, të moshuar dhe njerëz që nuk kishin asnjë mundësi mbrojtjeje.

Borova nuk është vetëm një emër në historinë shqiptare. Borova është një plagë e kujtesës kombëtare.

Është një vend ku dhimbja e së kaluarës bashkohet me detyrimin moral për të mbrojtur paqen dhe dinjitetin njerëzor.

Masakra e Borovës, një tragjedi ndaj civilëve të pafajshëm

Në verën e vitit 1943, gjatë Luftës së Dytë Botërore, Shqipëria ndodhej nën pushtimin italian dhe më pas atë gjerman. Rezistenca kundër forcave pushtuese ishte rritur dhe përplasjet mes forcave të rezistencës dhe trupave naziste kishin intensifikuar represionin ndaj popullsisë civile. Në këtë klimë dhune dhe hakmarrjeje, më 6 korrik 1943, trupat gjermane ndërmorën një operacion ndëshkues në zonën e Borovës. Fshati u sulmua dhe u shkatërrua.

Shtëpitë u dogjën. Banorët u vranë. Familje të tëra u goditën nga një tragjedi që ende sot përcillet nga brezi në brez. Viktimat nuk ishin ushtarë në një fushë beteje. Ata ishin njerëz të zakonshëm, nëna, baballarë, fëmijë dhe të moshuar. Ishin banorë që jetonin jetën e tyre dhe u përballën me pasojën më të rëndë të një lufte që nuk e kishin zgjedhur. Krimi i Borovës mbetet një kujtesë e dhimbshme e asaj se deri ku mund të arrijë dhuna kur humbet çdo kufi njerëzor.

Një ambasador në Borovë: kujtesa si përgjegjësi

Një element i rëndësishëm i kujtesës së Borovës është edhe prania ndër vite e përfaqësuesve të Gjermanisë në Shqipëri në ceremonitë përkujtimore.

Çdo vit, më 6 korrik, ambasadori i Gjermanisë në Tiranë ka qenë i pranishëm në Borovë për të nderuar viktimat shqiptare të masakrës së vitit 1943.

Kjo prani është më shumë sesa një akt diplomatik. Është një dëshmi e rëndësisë që ka përbërja me të kaluarën. Gjermania e sotme, si pjesë e familjes evropiane, ka ndërtuar një kulturë të kujtesës ku krimet e nazizmit nuk mohohen dhe nuk harrohen. Përkundrazi, ato kujtohen pikërisht që të mos përsëriten. Mesazhi i përcjellë nga përfaqësuesit gjermanë në Borovë ka qenë i qartë: Krimet e nazizmit ndaj njerëzimit duhen kujtuar, sepse vetëm duke njohur të kaluarën mund të ndërtohet një e ardhme më e drejtë dhe më paqësore. Ky qëndrim përbën një shembull të rëndësishëm të përgjegjesisë historike.



Kujtesa që na mban gjallë identitetin kombëtar

Borova na vendos përpara një pyetjeje të rëndësishme: Sa e mbajmë gjallë kujtesën tonë historike?

Përkujtimi i viktimave nuk duhet të jetë vetëm një ceremoni e një date të caktuar. Ai duhet të jetë pjesë e ndërgjegjes sonë kombëtare. Vendet e kujtesës janë shkolla të historisë. Ato u tregojnë brezave të rinj se liria dhe paqja nuk kanë ardhur pa sakrificë. Ato kujtojnë se indiferenca ndaj dhunës mund të sjellë pasoja tragjike. Ato na mësojnë se dinjiteti njerëzor duhet mbrojtur gjithmonë. Borova nuk kërkon hakmarrje nga historia. Borova kërkon kujtesë.

Kërkon që emrat e viktimave të mos mbeten vetëm në pllaka përkujtimore, por të jetojnë në ndërgjegjen e shoqërisë.

Kundër dhunës, një vlerë universale evropiane

Historia e shekullit XX na ka treguar se dhuna, ekstremizmi dhe urrejtja mund të shkatërrojnë shoqëri të tëra.

Pikërisht për këtë arsye, Evropa moderne është ndërtuar mbi disa parime themelore: respektin për jetën njerëzore, shtetin e së drejtës, demokracinë dhe kundërshtimin e çdo forme dhune. Kujtesa e Borovës lidhet drejtpërdrejt me këto vlera. Mesazhi që vjen nga ky vend nuk është vetëm shqiptar.

Është universal. Është një thirrje që krimet e së kaluarës

të mos përsëriten askund. Sepse viktimat e luftërave nuk janë vetëm statistika historike.

Ato janë njerëz me emra, familje, ëndrra dhe jetë të ndërprera padrejtësisht.

Borova, një amanet për brezat

Sot, pas shumë dekadash, Borova vazhdon të jetë një simbol. Një simbol i dhimbjes. Një simbol i sakrificës. Por edhe një simbol i përgjegjesisë njerëzore.

Në atë tokë u derdh gjaku i njerëzve të pafajshëm, por prej saj lind edhe një mesazh i fuqishëm: Asnjë ideologji, asnjë pushtet dhe asnjë luftë nuk mund të justifikojë vrasjen e njerëzve të pafajshëm.

Kujtimi i 107 viktimave të Borovës nuk i përket vetëm së kaluarës.

Ai është një detyrim për të tashmen. Dhe një premtim për të ardhmen. Sepse historia nuk duhet vetëm të shkruhet. Historia duhet të kujtohet. Dhe kujtesa duhet të shërbejë për paqen. 6 Korrik 1943 – Borovë -107 jetë të humbura. Një kujtesë që nuk shuhet. Një mesazh që mbetet: Kurrë më dhunë kundër njerëzimit.

6 Korrik në Borovë: Një homazh për viktimat dhe një thirrje për paqe

Çdo vit, më 6 korrik, në ditën e përkujtimit të Masakrës së Borovës, përfaqësuesi i Gjermanisë në Shqipëri është i pranishëm në Ersekë dhe në Borovë për të nderuar 107 shqiptarët e pafajshëm të vrarë gjatë krimeve naziste të vitit 1943.

Prania e ambasadorëve gjermanë ndër vite në këtë vend të dhimbjes dhe kujtesës përbën një gjest të rëndësishëm respekti ndaj viktimave dhe një dëshmi të përbaljes me të kaluarën historike.

Në heshtjen e memorialit të Borovës, ky akt merr një kuptim të veçantë: nuk është vetëm një homazh për ata që humbën jetën, por edhe një mesazh i fuqishëm për brezat e sotëm dhe të ardhshëm se krimet kundër njerëzimit nuk duhet të harrohen dhe nuk duhet të përsëriten.

“Të kujtojmë të kaluarën, për të mos lejuar që historia të përsëritet” – ky është mesazhi që përcillet çdo 6 korrik nga Borova. Në një kohë kur bota ende përballlet me konflikte dhe kërcënime ndaj paqes, kujtesa e Borovës mbetet një thirrje universale: dhuna nuk mund të jetë kurrë zgjidhje, ndërsa respekti për jetën dhe dinjitetin njerëzor duhet të jetë themeli mbi të cilin ndërtohet e ardhmja.

Prania e ambasadorit gjerman në Borovë është, mbi të gjitha, një shenjë përgjegjësie historike dhe një dëshmi se kujtesa, kur shoqërohet me reflektim dhe respekt, mund të shërbejë si urë mes popujve dhe si garanci për një “kurrë më” të vërtetë.



Një rrugëtim që nisi nga Berati
drejt uniformës dhe misionit

Dhanil Reveli lindi më 7 mars 1944, në qytetin e Beratit, në një familje të thjeshtë qytetare. Pas përfundimit të arsimit fillor dhe 7-vjeçar në vendlindje, në vitin 1958 ai do të niste një nga etapat më vendimtare të jetës së tij: pranimin në Shkollën e Mesme Ushtarake “Skënderbej”, në Tiranë.

Largimi nga familja në moshë të re, hyrja në jetën e disiplinuar ushtarake dhe përballja me një realitet të ri edukimi, përbënin një sfidë të madhe emocionale dhe njerëzore. Megjithatë, pikërisht aty do të formohej karakteri i tij si kuadër i ardhshëm i Forcave të Armatosura.

“Skënderbej” – Shkollë karakteri,
disipline dhe formimi elitar

Vitet në shkollën “Skënderbej” mbeten themelore në jetën e Dhanil Revelit. Ai i përshkruan ato si vite të një formimi të thellë, ku përveç dijes, u kultivuan vlerat e shoqërisë, disiplinës dhe përgjegjësisë.

Në këtë periudhë, ai krijoi miqësi të forta me bashkëmoshatarët e tij dhe përjetoi jetën intensive të shkollës ushtarake: stërvitjet, marshimet, aktivitetet edukative, pushimet dimërore në Karpen të Kavajës dhe jetën e përbashkët me shokët e klasës.

Nga nxënës elitar në oficer
i Forcave të Armatosura

Pas përfundimit të shkollës “Skënderbej” me rezultate të larta në vitin 1962, Dhanil Reveli u dërgua në Shkollën e Lartë të Bashkuar të Oficerëve “Enver Hoxha”, në degën gjitharmëshe.

Në vitin 1964 ai u diplomua me rezultate të shkëlqyera dhe u gradua nëntoger i klasit të parë, duke nisur shërbimin aktiv në Forcat e Armatosura të Republikës.

Rikthimi në “Skënderbej” si kuadër dhe edukator

Pas diplomimit, ai u emërua fillimisht zëvendëskomandant kompanie, ndërsa më pas iu besua detyra e rëndësishme e Sekretarit të Komitetit të Rinisë në Shkollën “Skënderbej” – duke u rikthyer aty ku nisi formimi i tij.

Nga viti 1964 deri në vitin 1971, ai kontribuoi në edukimin dhe formimin e nxënësve skënderbegas, duke qenë pjesë aktive e jetës organizative dhe edukative të shkollës.

Në këtë periudhë, ai bashkëpunoi me kuadro të shumtë ushtarakë dhe pedagogë, duke ndërtuar një eksperiencë të thellë në punën me rininë dhe në formimin e karakterit ushtarak të brezit të ri.

Familja dhe vazhdimësia e jetës

Në vitet 1968–1969, Dhanil Reveli krijoi familjen me zonjën Arta Reveli, gjithashtu pjesë e stafit të shkollës “Skënderbej”. Çifti ka tre fëmijë, të cilët janë të arsimuar dhe të integruar në institucione shtetërore.

Karrierë e gjerë në edukim dhe shërbim publik

Pas përfundimit të shërbimit në “Skënderbej”, ai vijoi karrierën në disa pozicione të rëndësishme:

- Shef Propagande në Korpusin e Tiranës
- Pedagog në shkollën e kuadrove rezervistë pranë Divizionit të Tiranës
- Mësues i Sociologjisë në gjimnazin “Çajupi” (1998–2003)
- Pedagog i jashtëm në Fakultetin e Infermierisë



DHANIL REVELI, HISTORIA E NJË BREZI QË FORMOI FORCAT E ARMATOSURA

Vitet në shkollën “Skënderbej” mbeten themelore në jetën e Dhanil Revelit. Ai i përshkruan ato si vite të një formimi të thellë, ku përveç dijes, u kultivuan vlerat e shoqërisë, disiplinës dhe përgjegjësisë.

(2003–2008)

Për kontributin e tij, ai është vlerësuar me:

- “Urdhrin e Kuq – Klasi II”
- “Urdhrin e Shërbimit Ushtarak – Klasi III”
-

Një jetë e përkushtuar ndaj edukimit dhe shtetit

Rrugëtimi i Dhanil Revelit është shembull i një brezi ku shërbimi ndaj atdheut, edukimi dhe formimi i të rinjve ishin

mision jetësor.

Ai përfaqëson figurën e kuadrit ushtarak dhe edukatorit që lidh disiplinën me humanizmin, përvojën me formimin, dhe detyrën me përkushtimin afatgjatë.

Nga nxënësi i një shkolle elitare ushtarake, në oficer, pedagog dhe edukator brezash, Dhanil Reveli mbetet një emër i lidhur ngushtë me historinë e shkollës “Skënderbej” dhe me traditën e formimit të kuadrove ushtarake shqiptare.

Një jetë në shërbim të dijes, disiplinës dhe atdheut.

KRISTAQ DHE MARGARITA TUTULANI, plumbat u morën jetën, historia u dha pavdekësinë

Ka data që nuk janë thjesht shënime në kalendar. Ato janë plagë të historisë dhe njëherazi gurë themeli mbi të cilët ndërtohet kujtesa kombëtare. 6 korriku 1943 është një prej atyre datave. Në Gosë të Kavajës, pushtuesit fashistë pushkatuan dy nga bijtë më të shquar të Beratit, motër e vëlla, Margaritën dhe Kristaq Tutulani. Ata ishin vetëm në fillim të jetës së tyre, por kishin zgjedhur të jetonin për një ideal më të madh se vetja: lirinë e Shqipërisë.

Sot, pas më shumë se tetë dekadash, emrat e tyre vazhdojnë të qëndrojnë të pashlyer në panteonin e dëshmorëve të Atdheut. Ata nuk përfaqësojnë vetëm heroizmin e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare; ata mishërojnë ndërthurjen e rrallë të kulturës, dijes, qytetarisë dhe sakrificës. Ishin intelektualë të rinj, me horizonte evropiane, që mund të kishin ndërtuar karriera të suksesshme, por zgjodhën të ndërprisnin studimet dhe të vendosnin fatin e vendit mbi fatin e tyre.

Për gazetën “Ushtria”, sjellja në kujtesë e figurave të tilla nuk është vetëm një detyrim moral ndaj historisë. Është një mision për të ruajtur trashëgiminë shpirtërore të kombit dhe për t’ua përcjellë brezave të rinj shembujt mbi të cilët ndërtohet dashuria për Atdheun.

Një familje që edukoi me dashurinë për Shqipërinë

Familja Tutulani ishte një nga familjet më të njohura dhe më të respektuara të Beratit. Tradita e saj nuk lidhej vetëm me kulturën dhe arsimin, por mbi të gjitha me shërbimin ndaj vendit.

Babai, Milto Tutulani, kishte shërbyer për katërmbëdhjetë vjet si deputet dhe kishte mbajtur postet e ministrit të Financave dhe të Drejtësisë në shtetin shqiptar. Në rrethin familjar spikaste edhe figura e Sotir Kolesë, një nga studiuesit më të rëndësishëm të gjuhës shqipe dhe një bibliofil i rrallë.

Në këtë mjedis u rritën Kristaqi dhe Margarita. Ata u edukuan me respektin për dijen, kulturën dhe përgjegjësinë qytetare. Por mbi të gjitha, u rritën me bindjen se Atdheu nuk është një nocion abstrakt; ai mbrohet me përkushtim, me punë dhe, kur e kërkon koha, edhe me sakrificën supreme.

Shtëpia e Tutulanëve u kthye në një nga bazat më të rëndësishme të lëvizjes antifashiste në Berat. Në të strehoheshin drejtues dhe veprimtarë të rezistencës, zhvilloheshin takime të fshehta dhe organizoheshin veprimtari kundër pushtuesit. Ishte një familje që kishte zgjedhur të mos ishte spektatore e historisë, por pjesë aktive e saj.

Margarita, zëri i grave shqiptare në rezistencë

Në verën e vitit 1942, Margarita ndërpreu studimet në Institutin Femëror të Tiranës dhe u kthye në Berat. Ajo kishte marrë një detyrë të vështirë, të organizonte gratë dhe vajzat në rezistencën kundër pushtimit fashist.

Në një shoqëri ku pjesëmarrja e grave në jetën politike dhe shoqërore ishte ende e kufizuar, Margarita u bë një simbol i guximit qytetar. Ajo shkonte lagje më lagje, zhvillonte mbledhje, shpërndante materiale, fliste me gratë dhe të rejat, duke i bindur se lufta për lirinë ishte përgjegjësi e të gjithëve.

Kulmi i kësaj veprimtarie ishte demonstrata historike e 28 Nëntorit 1942 në Berat. Nën drejtimin e saj, mijëra qytetarë dolën në rrugët e qytetit, grisën simbolet e pushtuesit, kërkuan



lirimin e të burgosurve politikë dhe sfiduan hapur autoritetet fashiste.

Në shkallët e monumentit kushtuar Rilindësve, Margarita mbajti një fjalim që mbeti gjatë në kujtesën e qytetit. Ishte një thirrje për liri, dinjitet dhe qëndresë. Që nga ajo ditë ajo u detyrua të kalonte në ilegalitet, duke vazhduar pa ndërprerje veprimtarinë në shërbim të rezistencës.

Kristaqi, intelektual i zgjedhur për pushkën e lirisë

Edhe Kristaqi bëri të njëjtën zgjedhje. Në tetor të vitit 1942 ai ndërpreu studimet për Drejtësi në Firence dhe u kthye në Shqipëri.

Ai përfaqësonte tipin e intelektualit modern shqiptar. Zotëronte disa gjuhë të huaja, njihte letërsinë klasike dhe bashkëkohore evropiane, përkthente autorë të mëdhenj dhe shkruante me një pjekuri të pazakontë për moshën e tij.

Kristaqi nuk ishte njeri i retorikës boshe. Ai besonte se forca e argumentit ishte po aq e rëndësishme sa forca e armës. Në pak muaj u shndërrua në një nga organizatorët më aktivë të lëvizjes antifashiste në qarkun e Beratit. Ai zhvilloi një punë të gjerë propagandistike dhe organizative, duke kontribuar në zgjerimin e rezistencës në qytet dhe në zonat përreth.

Në atë periudhë, qarku i Beratit ishte kthyer në një nga zonat më aktive të luftës kundër pushtuesit. Çeta dhe batalione partizane vepronin në shumë krahina, ndërsa aksionet kundër forcave pushtuese po shtoheshin dita-ditës.

Në këtë klimë rezistence, Kristaq Tutulani dha një kontribut të rëndësishëm në mobilizimin e rinisë dhe të popullsisë.

Luftëtarë të armës dhe të penës

Ajo që i bën edhe më të veçantë Kristaqin dhe Margaritën është fakti se ata nuk ishin vetëm luftëtarë. Ata ishin krijues.

Dorëshkrimet e ruajtura deri në ditët tona dëshmojnë për një botë të pasur shpirtërore dhe intelektuale. Poezi, ese, ditarë, përkthime, refleksime filozofike dhe publicistikë flasin për dy të rinj me kulturë të jashtëzakonshme.

Kristaq Tutulani ishte ndër të parët që e cilësoi Migjenin si “uragan i ndërprerë në mes”, një vlerësim që më vonë do të bëhej pjesë e kritikës letrare shqiptare. Ai ëndërronte një Shqipëri demokratike, të ndërtuar mbi dijen, kulturën dhe qytetarinë.

Edhe Margarita la pas ditarë, poezi, hartime dhe punime artistike që tregojnë ndjeshmërinë dhe inteligjencën e saj. Nëse historia nuk do t’ua kishte ndërprerë jetën, Shqipëria do të kishte fituar dy personalitete të shquara të kulturës kombëtare.

6 korriku 1943, dita kur u bënë të pavdekshëm

Në fillim të korrikut 1943, Kristaqi dhe Margarita ranë në duart e pushtuesve.

Më 6 korrik, në Gosë të Kavajës, ata u pushkatuan. Nuk kërkuan falje. Nuk tradhtuan. Nuk mohuan idealin për të cilin kishin luftuar.

Ata u përballën me vdekjen me të njëjtin dinjitet me të cilin kishin jetuar.

Në atë çast, dy jetë të reja u shuan, por një simbol lindi përgjithmonë.

Kujtesa është detyrim

Sot, kur Shqipëria është pjesë e aleancës më të madhe të mbrojtjes kolektive dhe Forcat e Armatosura shërbejnë për paqen, sigurinë dhe mbrojtjen e vendit, kujtimi i dëshmorëve mbetet një nga shtyllat morale të identitetit ushtarak.

Liria nuk është një e mirë e dhënë përgjithmonë. Ajo është trashëgimi e fituar me gjakun e brezave që na paraprinë.

Prandaj gazetës “Ushtria” i takon të mbajë gjallë këtë kujtesë. Të rikthejë në vëmendje emrat e atyre që nuk kërkuan lavdi personale, por zgjodhën të sakrifikojnë gjithçka për Shqipërinë.

Kristaq dhe Margarita Tutulani nuk janë vetëm dy emra në një monument apo në një faqe historie. Ata janë një model i përgjeshëm për çdo brez shqiptar. Na kujtojnë se forca e një kombi nuk matet vetëm me armët që zotëron, por edhe me idealet që është i gatshëm të mbrojë.

*Prandaj ata mbeten, sot dhe përgjithmonë, **Yje të Pashuar**. Drita e tyre vazhdon të ndriçojë rrugën e kujtesës kombëtare, duke u kujtuar brezave se liria ka emra, ka fytyra dhe ka dëshmorë që nuk harrohen kurrë.*





Prof. Asoc. Dr. BERNARD ZOTAJ

Struktura e thjeshtë e një libri tërheqës

Këto ditë në qytetin e Pogradecit, takova mikun tim të punës në doktrinën ushtarake, Tomor Mukaj. Nëpërmjet rrjeteve sociale isha njohur me botimin e librit “Vlusha, një emër që flet me zërin e shekujve”. E urova përsëri dhe i shpreha kënaqësinë për ta lexuar dhe njohur me historinë e fshatit Vlushë. Vlusha për mua ishte e njohur, sepse aty ishte formuar një nga formacionet e UNÇSH-së, Brigada VII Sulmuese, një formacion partizan me një histori të lavdishme.

Gjatë leximit të librit ndesha me një strukturë të thjeshtë, por domethënëse, ku që në parathënien e përgatitur me kulturë, Zylyftar Hoxha mëson se libri shpalos një histori të një fshati dhe të njerëzve të tij, të pasur në ngjarje e dëshmi historike me karakter kombëtar, ndoshta si asnjë tjetër në krahinën e Skraparit. Ndaj ky fshat nuk mund të mbetej pa histori të shkruar.

Autori me formim akademik e ka organizuar librin me tri kapituj. Në kapitullin e parë, që bën fjalë për histori dhe gjeografi, gjendet një hyrje që lexuesi përgatitet për të marrë të dhëna për historinë e Vlushës në mezolit, në neolit dhe në antikitet, më tej shpalosen histori nën sundimin bullgar, për të vijuar me periudhën e sundimit Osman, luftërat botërore, si dhe një njohje me gjeografinë e zonës dhe të Vlushës.

Kapitullin e dytë e ka përqendruar tek jetesa dhe traditat, veçanërisht është ndalur në vendosjen e fshatit, jetesën, mjetet e punës, dasmat dhe ritet, objektet e kultit dhe besimin fetar; është ndalur tek burimet ujore, ushqimet dhe gatimet, frutat dhe bimët kurative. Më tej është marrë me toponimet dhe emërtimet, objektet e rëndësishme të fshatit, ka analizuar lojërat argëtuese. Gjatë është ndalur tek arsimi dhe shkolla në fshat, pushteti dhe këshilli popullor, kolektivizimi, transporti, tregtia, rrugët, urat dhe mulliri. Nga fundi i kapitullit ka folur për lumin e Vlushës dhe hidrocentralet, është ndalur tek institucioni i varrimit. E veçanta e këtij kapitulli janë disa shpjegime të fjalëve të fshatit dhe të zonës, që e bëjnë më të këndshëm leximin.

Kapitulli i tretë i kushtohet demografisë dhe rrënjëve e fiseve. Ka bërë pemët gjenealogjike të fshatit Vlushë, duke analizuar fiset e fshatit si: Shatri, Muka, Borri, Çollaku, Sanxhaku (Sanxhakët e Mazrekës, Korçë dhe të Çepanit e Qafëzesit të Ersekës), Mançe dhe Hajdini. Risi është se ka bërë një apel të familjeve të fshatit Vlushë në vitin 2026.

Pra, siç edhe shihet është një enciklopedi mjaft e pasur për një fshat me histori, me njerëz fisnikë dhe me tradita patriotike të ruajtura fort në zemrën e çdo vlushari dhe në thellësinë e maleve legjendë Gostëncës.


Vlusha, një emër që zgjon histori

Vlusha është e përmendur në historinë zyrtare të Shqipërisë si një prej vendbanimeve më të hershme të jetës në Europë, gjurmë që zbresin deri në kohët e mezolitit të hershëm. Autori njeh lexuesin me historinë në periudhën osmane, që Vlusha ishte qendër administrative e rëndësishme, me status të ruajtur në forma të ndryshme deri në sistemin socialist. Njihej si Vlusha, në luftërat botërore ishte vatër e qëndresës kundër shovinizmit grek, por njëkohësisht ishte dhe rezidencë e gjeneralit Gjilardi, përfaqësues austriak.

Vlusha në Luftën e Dytë Botërore zë një vend nderi në histori: aty u formua Brigada VII Sulmuese, formacion i rëndësishëm i luftës partizane në Shqipëri; Vlusha mbart plagë të thella, masakrën naziste të 14 janarit 1944, ku përjetoi vrasjen e 23 burrave dhe djemve. Aty, në Vlushë u dukën misionet angleze që ndihmuan me ndihma këtë luftë të shenjtë të popullit shqiptar.

Si një ushtarak i nivelit të lartë dhe i përgatitur, Tomor Mukaj në libër ka sjellë mjaft episode me vlera, momente historike, ngjarje dhe njerëz që rrëfejnë. E veçanta në libër është se autori ka sjellë rrëfime konkrete për ngjarje, për njerëz me histori të vogla, por që i japin librit frymë të re.

Shekujt flasin për historinë e Vlushës



Ndjej respekt për Tomor Mukajn, që me guxim, me kurajë dhe me këmbëngulje realizoi botimin e librit mbi historinë e Vlushës. Librin autori e ka shkruar me zemër, me mjeshtëri, me një stil të admirueshëm dhe me një qartësi mendimi për çdo ngjarje, ndodhi dhe rrëfime dëshmitarësh. Libri ka një gjuhë të pastër dhe një rrjedhshmëri në të lexuar, por edhe risi, të cilat flasin për një autor me botë dhe kulturë të gjithanshme, që çdo germë është në vendin e vet.

Ajo që bie në sy gjatë leximit të librit është se historitë nuk gjenden në dokumente zyrtare, por ato jetonin në kujtesën e njerëzve, në rrëfimet e të moshuarve, në emrat e vendeve, në traditat dhe në gjurmët që kanë lënë brezat ndër kohë. Ndaj u desh pena e Tomor Mukajt që këto të vijnë të radhitura me kujdes dhe me mjeshtëri prej një ushtaraku, duke i lënë si

trashëgimi që të përcillen në breza. Libri jep një panoramë të plotë të rrugëtimit historik të fshatit, duke i prurë banorët e këtij fshati të tregojnë dhe të rrëfejnë historinë si ka qëndruar në shekuj dhe të nxjerrë në pah vlerat, traditat, doket dhe zakonet që i kanë bërë grusht për të përballuar vështirësitë e jetës.

Misioni i librit është që të ruajë dhe të përcjellë kujtesën historike të fshatit për brezat e sotëm dhe të ardhshëm. Njohja e rrënjëve dhe e traditave tona është një mënyrë për të kuptuar më mirë se kush jemi dhe nga vijmë.

Vlusha në Luftën e Dytë Botërore

Vlusha u lidh ngushtë me Luftën Nacionalçlirimtare dhe familjet e mëdha e të dëguara të Vlushës dhe të zonës së Skraparit, të cilat ndikuan për pjesëmarrjen në luftë. Lidhja e Sinan Yllit të Leshnjës me Luftën ndikoi edhe në fshatin Vlushë. Rezistenca ndaj pushtimit italian u përkrah nga të rinjtë e fshatit si Mehmet Çollaku, Safet Hajdini dhe Muço Mançe etj. Këta ishin të parët që dezertuan nga radhët e ushtrisë në vitet e pushtimit italian. Më 14 shkurt 1943, në Vlushë u formua Këshilli Antifashist Nacionalçlirimtar me kryetar Neshat Mançen dhe sekretar Muço Mançen, u krijua edhe organizata e rinisë antifashiste të fshatit me sekretar Fasli Çollakun. Në zonë dhe në fshat pati dhe simpatizantë të Ballit Kombëtar.

Në tetor të vitit 1943, në malet e Vlushës dhe të Leshnjës u krye zbarkimi i forcave parashutiste të aleatëve, të cilat erdhën pranë popullit tonë për të vendosur lidhje me forcat shqiptare të organizuara kundër trupave pushtuese. Ky zbarkim kishte për qëllim edhe ofrimin e ndihmave dhe materialeve ushtarake për forcat partizane të zonës Korçë–Skrapar.

Në operacionin e Dimrit, më 14 janar 1944, një detashment ndëshkimi gjerman kreu një masakër, duke vrarë 23 burra dhe djem të pafajshëm. 21 burra ishin nga Vlusha dhe dy dervishë i sollën gjermanët me vete. Të dhënat flasin se ata ishin dervishë të Teqesë së Prishtës. 20 prej burrave të vrarë në Vlushë u shpallën dëshmorë të atdheut. Në mesin e fshatit është ngritur përmendorja në kujtim të martirëve, dëshmorë.

Në Vlushë, më 17 mars 1944, u formua Brigada VII Sulmuese e Ushtrisë Nacionalçlirimtare. Edhe për këtë ngjarje u ngrit lapidari në pllakën përkujtimore të të cilit janë gdhendur emrat e gjithë dëshmorëve të brigadës që luftoi kundër nazistëve gjermane deri në Vishegrad.

Në Vlushë ka funksionuar spitali partizan në shtëpinë e Hysen Mançes. Spitali partizan shërbeu nga muaji prill deri në qershor 1944, kur gjatë operacionit të këtij muaji hordhitë erdhën përsëri në fshat dhe e dogjën atë.

“Iu paça të gjithëve!”

Autori në vend të mbylljes së librit, pi tri dolli Skrapari me tri gota.

Monografia për Vlushën ka qenë dëshirë e autorit që shumë vite më parë. Lindur në Vlushë, por larguar që fëmijë, i edukuar në një mjedis ushtarak iu shtua dëshira dhe dashuria për fshatin dhe për njerëzit ishte i përmalluar.

Autori në faqet e librit sjell brezat me të dhëna konkrete, duke treguar se kush ishin dhe rrënjët që kishte fshati në thellësinë historike. Kështu ka arritur të bëjë bashkë në gerrat e këtij libri bashkëfshatarët e tij, njerëzit, traditat, zakonet dhe mënyrën e jetesës, në fshatin e largët dhe të futur mes maleve hijerëndë, Vlushën.

Libri është një punim përmbledhës, është mirënjohjeje për burrat dhe gratë e fshatit që mbajtën gjallë vazhdimësinë e jetës së tyre në çdo kohë dhe situatë të krijuar në shekuj. Autori sjell kujtime të burrave dhe grave që punuan me mish e me shpirt të rritur dhe arsimuar fëmijët, tregon vështirësitë e kohërave që kanë rritur njerëz me karakter të fortë, me ndershmëri dhe përkushtim për jetën.

Ndaj dollinë e parë autori e ngre për brezat e rinj me mesazhin se “pa njohur nga vijmë, nuk dihet se ku shkojmë”, ndaj brezat që vijnë nuk duhet ta harrojnë Vlushën, rrënjët, dhe paraardhësit e tyre.

Dollia e dytë për gjermanin e habitur dhe e treta për të gjithë bashkëpunëtorët në përgatitjen e librit...

Urime mik i dashur për këtë punë të bukur të bërë me zemër, të thurur me dëshirë dhe të begatë për brezat që vijnë...

Superkompjuteri britanik “Dawn” mbyllet për shkak të valës së të nxehtit

Një nga superkompjuterët më të shpejtë të inteligjencës artificiale në Mbretërinë e Bashkuar, i njohur si “Dawn”, ka qëndruar jashtë funksionit për më shumë se një javë pasi vala e të nxehtit e fundit e detyroi të fiket. Pajisja, e cila ndodhet në Universitetin e Kembrixhit dhe përdoret nga studiues të klimës dhe kancerit, u mbyll më 27 qershor kur temperaturat në kampus arritën 30°C. Universiteti njoftoi se aksesimi do të rikthehet të hënën, ndërsa temperaturat pritet të zbresin në fund të javës.

Një goditje për kërkimin shkencor

“Dawn” është një superkompjuter me vlerë miliona paund, i cili ka mbështetur mbi 350 projekte shkencore, përfshirë parashikimet e ndryshimeve të akullit në Antarktidë dhe modelimin e klimës globale. Ai ka ndihmuar gjithashtu në zhvillimin e vaksinave të personalizuara kundër kancerit dhe është cilësuar si një “plumb magjik” nga Universiteti i Kembrixhit për aftësinë e tij për të zbuluar tumore në skanime të veshkave.

Profesor Lennard Lee nga Universiteti i Oksfordit, i cili drejton projektin e vaksinës kundër kancerit me ndihmën e AI-së, tha se ndërprerja ka pezulluar punën e tyre, por nuk ka shkaktuar humbje të të dhënave. “Nuk ka humbje informacioni dhe nuk pritet të përsëritet puna”, theksoi ai.

Shkaku: dështimi i sistemit të ftohjes

Mesazhet e brendshme të qendrës së të dhënave në West Cambridge e përshkruan incidentin si një “dështim” të sistemit të ftohjes. Procesorët e fuqishëm të superkompjuterëve zakonisht ftohen me ventilatorë ose sisteme me lëngje, por vala e të nxehtit e tejkaloi kapacitetin e tyre. Kompania franceze Legrand, pronare e firmës britanike USystems që ndërtoi teknologjinë e ftohjes, deklaroi se pajisjet “funksionuan sipas specifikimeve” dhe nuk pati defekt teknik.

Profesor Simon McIntosh-Smith nga Universiteti i Bristolit paralajmëroi se investimi në sisteme ftohjeje që përballojnë temperatura deri në 50°C do të ishte shumë i kushtueshëm, por pranoi se superkompjuterët janë “burime jetike” dhe rrezikohen nga moti ekstrem gjithnjë e më i shpeshtë.

Një paralajmërim për të ardhmen

Qershori i këtij viti ishte më i nxehti i regjistruar ndonjëherë në Angli dhe i dyti më i nxehti në Mbretërinë e Bashkuar. Rekord i ri prej 37.7°C u vendos më 26 qershor në Norfolk, duke tejkaluar shifrat e famshme të vitit 1976. Ndërkohë, vala e tretë e të nxehtit për këtë vit ka detyruar shkollat të anulojnë ditët sportive dhe të lejojnë nxënësit të veshin uniforma më të lehta.

Jonathan Hirst nga Universiteti i Nottinghamit tha se “nxehtësia ekstreme po shfaqet më shpesh se sa pritej disa vite më parë” dhe sugjeroi se programimi më efikas dhe menaxhimi i të dhënave mund të ndihmojnë qendrat e të dhënave të shmangin mbinxehjen.

Investime dhe e ardhmja e superkompjuterit

Në janar, qeveria britanike njoftoi një investim prej 36 milionë paund për të rritur fuqinë e Dawn gjashtëfish. Versioni i ardhshëm, i quajtur Zenith, do të zhvillohet në bashkëpunim me Dell, AMD dhe Stack HPC. Synimi është që Mbretëria e Bashkuar të ketë një infrastrukturë më të qëndrueshme për kërkime shkencore, duke përballuar sfidat e klimës gjithnjë e më ekstreme.

Ky incident është një kujtesë e fortë se teknologjia më e avancuar nuk është e paprekshme ndaj kushteve atmosferike. Ndërsa superkompjuterët si Dawn janë motorë të progresit



shkencor, ata mbeten të varur nga sistemet e ftohjes dhe energjisë – dhe nga një klimë që po bëhet gjithnjë e më e paparashikueshme.

Teknologjia dhe sfidat e së ardhmes

Rasti i superkompjuterit Dawn është një shembull i qartë se si teknologjia më e avancuar përballlet me kufizime të botës reale. Ndërsa fuqia e llogaritjes rritet me ritme marramendëse, sfidat e infrastrukturës – si energjia, ftohja dhe qëndrueshmëria – po bëhen po aq kritike sa vetë kapaciteti i procesimit.

Energjia dhe qëndrueshmëria

Superkompjuterët konsumojnë sasi të mëdha energjie. Me rritjen e kërkesës për inteligjencë artificiale dhe modelime komplekse, qendrat e të dhënave duhet të gjejnë mënyra më efikase për të reduktuar konsumin. Investimet në energji të rinovueshme dhe teknologji ftohjeje më të gjelbër janë të domosdoshme për të shmangur ndikimin negativ në klimë.

Ftohja si faktor kritik

Incidenti i Dawn tregon se sistemet e ftohjes janë pika më e dobët e superkompjuterëve. Në të ardhmen, mund të shohim përdorimin e metodave inovative si ftohja me ujë të detit, zhytja e serverëve në lëngje dielektrike, apo vendosja e qendrave të të dhënave në rajone më të ftohta për të ulur rrezikun e mbinxehjes.

Rritja e motit ekstrem

Me ndryshimet klimatike, valët e të nxehtit pritet të bëhen më të shpeshta dhe më intensive. Kjo do të thotë se arkitektura e qendrave të të dhënave duhet të projektohet për kushte më ekstreme se sa parashikohej disa vite më parë. Pa këtë përshtatje, rreziku i ndërprerjeve të ngjashme do të mbetet i lartë.

Optimizimi i softuerit

Jo gjithçka varet nga hardueri. Programimi më efikas, algoritmet që përdorin më pak burime dhe menaxhimi inteligjent i të dhënave mund të reduktojnë ngarkesën mbi sistemet. Kjo është një fushë ku bashkëpunimi mes inxhinierëve të softuerit dhe arkitektëve të harduerit do të jetë vendimtar.

E ardhmja e superkompjuterëve

Projekti Zenith, pasardhësi i Dawn, pritet të jetë shumë më i fuqishëm. Por fuqia e tij do të ketë kuptim vetëm nëse shoqërohet me infrastrukturë të qëndrueshme dhe rezistente ndaj kushteve klimatike. Përndryshe, rreziku i ndërprerjeve do të mbetet një pengesë e madhe për kërkimin shkencor.

Në fund, historia e Dawn nuk është thjesht një incident teknik – është një paralajmërim për të ardhmen. Teknologjia nuk mund të shihet e ndarë nga mjedisi ku funksionon. Superkompjuterët e gjeneratës së ardhshme duhet të projektohen jo vetëm për shpejtësi, por edhe për rezistencë ndaj klimës së re globale.

Inteligjenca Artificiale (AI) është një nga fenomenet më të jashtëzakonshme të kohës sonë. Ajo nisi si një ide e thjeshtë në laboratorët akademikë të viteve '50, kur shkencëtarët kërkonin të kuptonin se si mund të imitohej mendimi njerëzor përmes makinerive. Në fillimet e saj, AI-ja ishte një projekt teorik, i kufizuar në algoritme të thjeshta logjike, pa ndikim të drejtpërdrejtë në jetën e përditshme. Por me kalimin e dekadave, fuqia llogaritëse u rrit, rrjetet neuronale u zhvilluan, dhe AI-ja filloi të shfaqej si një teknologji praktike.

Në vitet '90 dhe 2000, AI-ja u integrua në industri: motorët e kërkimit, sistemet e rekomandimit, diagnostikimi mjekësor, menaxhimi i trafikut. Ajo u bë një mjet i fuqishëm për të optimizuar procese dhe për të kursyer kohë. Por transformimi i vërtetë ndodhi në dekadën e fundit, kur modelet e mëdha gjuhësore dhe algoritmet e avancuara të mësimiit të makinerive e shndërruan AI-në në një ekosistem të plotë. Sot, ajo është në zemër të çdo sektori: nga shëndetësia te arsimi, nga energjia te kultura.

Ky evolucion është trajtuar me forcë edhe nga Dr. Sergey Lagodinsky, eurodeputet i "Bündnis 90/Die Grünen", i cili në shkrimin e tij paralajmëron se prezantimi i modelit "Mythos" nga kompania "Anthropic" shënon një pikë kthese. Përtej dimensionit politik që ai nënvizon, ky zhvillim na fton të reflektojmë mbi dimensionin teknologjik: çfarë do të thotë për shoqërinë, për industrinë dhe për të ardhmen tonë digjitale?

Shkalla e inovacionit, pse kapitali është i domosdoshëm

AI-ja nuk është më një teknologji që mund të zhvillohet në laboratorë të vegjël me buxhete modeste. Modelet e mëdha kërkojnë fuqi llogaritëse kolosale, serverë të avancuar, çipa të specializuar dhe investime marramendëse. Në këtë kontekst, suksesi nuk varet vetëm nga ideja, por nga shkalla.

Për shembull, modelet si Mythos apo të tjera të ngjashme kërkojnë qindra mijëra GPU të lidhura në sisteme të shpërndara. Kjo është arsyeja pse kompanitë e mëdha teknologjike investojnë trilionat dollarë në infrastrukturë. Europa, për të konkurruar, duhet të mobilizojë kapital privat dhe të krijojë ekosisteme bashkëpunimi mes universiteteve, laboratorëve dhe industrisë.

Në vend që të shihet si garë për dominim, zhvillimi i AI-së mund të kthehet në një projekt bashkëpunimi. Kjo do të siguronte që inovacioni të mos mbetet i përqendruar në pak duar, por të përhapet në mënyrë të barabartë në gjithë kontinentin.

Etika dhe besimi publik, baza e legjitimitetit

Një aspekt që shpesh neglizhohet në debatet teknologjike është besimi i qytetarëve. AI-ja nuk mund të zhvillohet pa transparencë dhe pa respekt për privatësinë. Europa ka qenë pioniere në rregullimin e teknologjisë përmes standardeve të forta etike dhe ligjore – si Rregullorja e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave (GDPR) dhe Akti Evropian për AI-në.

Këto rregulla nuk janë pengesë për inovacionin, por garanci për përdorim të sigurt dhe të përgjegjshëm të teknologjisë. Nëse qytetarët ndihen të mbrojtur dhe të informuar, ata do ta pranojnë AI-në si pjesë të jetës së tyre. Për këtë arsye, kompanitë duhet të investojnë jo vetëm në zhvillim teknik, por edhe në komunikim publik, edukim digjital dhe transparencë.

Inteligjenca Artificiale si motor i qëndrueshmërisë

Një nga dimensionet më premtuese të AI-së është aftësia e saj për të ndihmuar në zgjidhjen e krizave globale. Algoritmet mund të analizojnë sasi të mëdha të dhënash për të optimizuar përdorimin e energjisë, për të parashikuar ndryshimet klimatike, apo për të përmirësuar sistemet e transportit publik.

Shembuj konkretë:

Shëndetësia: AI-ja përdoret për të analizuar imazhe mjekësore dhe për të diagnostikuar sëmundje si kanceri në faza shumë të hershme. Sistemet e bazuara në AI ndihmojnë mjekët të marrin vendime më të shpejta dhe më të sakta, duke shpëtuar jetë. Gjithashtu, algoritmet parashikojnë shpërthimet e epidemive duke analizuar të dhënat e mobilitetit dhe klimës.

Energjia: AI-ja ndihmon në menaxhimin e rrjeteve elektrike, duke balancuar prodhimin dhe konsumimin e energjisë në kohë reale. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për integrimin e burimeve të rinovueshme si dielli dhe era, të cilat kanë variabilitet të lartë. Arsimi: Platforma të bazuara në AI personalizojnë përvojën e nxënësve, duke përshtatur materialet sipas ritmit dhe stilit të të mësuarit. Kjo jo vetëm që rrit efikasitetin e mësimiit, por edhe ndihmon mësuesit të identifikojnë nevojat individuale të nxënësve.



Inteligjenca Artificiale, nga laboratorët te transformimi i jetës sonë digjitale

Në bujqësi, AI-ja ndihmon në menaxhimin e ujit dhe tokës; në urbanistikë, krijon qytete më inteligjente dhe më të gjelbra. Në industrinë e energjisë, AI-ja mund të parashikojë kërkesën dhe të balancojë prodhimin, duke reduktuar humbjet dhe duke rritur efikasitetin.

Dimensioni kulturor dhe social

AI-ja nuk po ndryshon vetëm ekonominë, por edhe kulturën dhe shoqërinë. Në art, algoritmet krijojnë muzikë, piktura dhe filma. Në media, ato gjenerojnë tekste dhe analizojnë audiencat. Në edukim, personalizojnë përvojën e nxënësve dhe ndihmojnë mësuesit të përshtatin metodat e tyre.

Por ky transformim sjell edhe pyetje të reja: çfarë do të thotë kreativitet kur një algoritëm mund të krijojë poezi? Çfarë do të thotë edukim kur një sistem mund të personalizojë çdo mësim? Këto pyetje nuk kanë përgjigje të thjeshta, por tregojnë se AI-ja është më shumë se teknologji – është një fenomen kulturor.

Nga frika te mundësia

Shkrimi i Dr. Sergey Lagodinsky na kujton një të vërtetë themelore: çdo revolucion teknologjik sjell me vete rreziqe, por edhe mundësi. Inteligjenca Artificiale është ndoshta mjeti më i fuqishëm që ka krijuar ndonjëherë njeriu. Ajo ka potencialin të ndryshojë mënyrën si jetojmë, punojmë dhe ndërveprojmë me botën përreth. Por ky potencial është i dyfishtë – mund të shërbejë për përmirësimin e jetës, ose mund të kthehet në instrument kontrolli dhe pasigurie. Sfida jonë nuk është ta ndalojmë, por ta drejtojmë me mençuri.

Frika: rreziqet e një teknologjie pa kontroll

Frika ndaj AI-së nuk është e pabazë. Modelet e avancuara mund të depërtojnë në sisteme të ndjeshme, të manipulojnë informacionin dhe të krijojnë pasiguri në infrastrukturën digjitale. Ekziston rreziku i humbjes së vendeve të punës për shkak të automatizimit, i përhapjes së dezinformimit përmes gjenerimit të përmbajtjes së rreme, apo i përdorimit të AI-së për qëllime ushtarake dhe survejimi masiv. Këto janë skenarë që e bëjnë shoqërinë të ndjehet e pasigurt dhe që nxisin skepticizëm ndaj teknologjisë.

Frika lidhet edhe me mungesën e transparencës. Shumë qytetarë nuk e kuptojnë se si funksionojnë algoritmet, çfarë të dhënash përdorin dhe si merren vendimet. Pa një kuadër të qartë etik dhe ligjor, AI-ja mund të perceptohet si një "kuti e zezë" që kontrollon jetën tonë pa llogaridhënie.

Mundësia: AI-ja si motor i përparimit

Por përtej frikës, AI-ja ofron mundësi të jashtëzakonshme. Në shëndetësi, ajo mund të diagnostikojë sëmundje në faza të hershme, të parashikojë shpërthimet e epidemive dhe të ndihmojë në zhvillimin e ilaçeve të reja. Në energji, mund të optimizojë përdorimin e burimeve, të balancojë prodhimin dhe konsumimin, dhe të ndihmojë në integrimin e burimeve të rinovueshme. Në arsim, mund të personalizojë përvojën e nxënësve, duke i ndihmuar të mësojnë sipas ritmit dhe nevojave të tyre.

AI është gjithashtu një mjet i fuqishëm për të adresuar sfidat globale si ndryshimet klimatike. Algoritmet mund të analizojnë miliona të dhëna për të parashikuar skenarë të ardhshëm dhe për të ndihmuar në marrjen e vendimeve të qëndrueshme. Në bujqësi, AI-ja ndihmon fermerët të përdorin më pak ujë dhe pesticide, duke rritur prodhimin dhe duke mbrojtur mjedisin.

Drejtimi i mençur: balanca mes inovacionit dhe etikës

Sfida jonë nuk është të ndalojmë zhvillimin e AI-së – kjo është e pamundur. Sfida është ta drejtojmë në mënyrë që të shërbejë për përmirësimin e jetës, jo për kontrollin e saj. Kjo kërkon një kombinim të tre elementeve:

- Rregullim të qartë dhe etikë: ligje që sigurojnë transparencë, mbrojtje të privatësisë dhe përdorim të përgjegjshëm.
 - Investime në inovacion: kapital për të ndërtuar infrastrukturë të fuqishme dhe për të mbështetur kërkimin shkencor.
 - Besim publik: edukim digjital dhe komunikim i hapur me qytetarët, që ata të ndihen pjesë e këtij transformimi.
- Historia na ka treguar se çdo teknologji e madhe ka sjellë fillimisht frikë. Elektriciteti, interneti, energjia bërthamore – të gjitha janë parë si kërcënime përpara se të shndërroheshin në mundësi. AI-ja nuk bën përjashtim. Por ashtu si me teknologjitë e tjera, suksesi varet nga mënyra se si e përdorim.



Shtoji Shqipërisë një yll

